



**DITA BOTËRORE E PAQES,
FRYMËZIM PËR T'U NDARË
NGA HARAMET DHE ZULLUMET!**



**MUHAMMEDI (A.S)
KRENARIA E GJITHËSISË!**



**RA SHEHIT TURKU,
PËR SHKODRËN**

UDHA ISLAME

Viti 21 - Nr. 9 (247), Shtator, 2023

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



MYFTINIA SHKODER1990

"Dhe NE, ta ngritëm lart famën TËNDE!"



**"HZ. MUHAMMEDI (A.S),
DRITË UDHËZIMI PËR GJITHËSINË!"
AKTIVITET ME RASTIN E MEVLUDIT SHERIFË**



(f. 17)

**MYFTIU: "MEDRESEJA JONË,
GJURMË E LASHTË E EDUKIMIT DHE DIJES!"**



(f. 16)



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Falënderimet dhe madhështia absolute i takojnë vetëm Allahut të Madhëruar, Zotit të Vetëm të Gjithësisë.

Atë e falënderojmë që na bëri nga muslimanët dhe na udhëzoi në këtë fé të pastër, ku gjithsecili nga ne është vëlla me atë që ka në krah.

Pejgamberi (a.s) thotë: “Muslimani është vëlla i muslimanit!”

Të gjitha salavatet më të përzemërta ia dërgojmë sot në këtë ditë dhe në çdo moment të jetës sonë, më të mirit dhe më të shtrenjtë të krijesave të Allahut (xh.sh), Hz. Muhammedit (a.s), i cili na udhëzoi drejt më të mirës dhe na mësoi çdo gjë që na duhet për jetën tonë.

Kushdo që kërkon udhëzimin në këtë botë ka një derë garante, ajo derë është dera e Hz. Muhammedit (a.s)! Kushdo që do të rregullojë marrëdhënien e tij me Allahun (xh.sh) le të trokasë në derën e Hz. Muhammedit (a.s), sepse dera e tij është garanci për tërheqjen e mëshirës së Allahut (xh.sh).

Pejgamberi (a.s) është dërguar mëshirë për të gjitha krijesat!

Në Kur'anin Famëlartë, në suren Ali Imran, lexojmë një ajet në të cilin Allahu (xh.sh) na tërheq vëmendjen dhe na thotë: “Përkujtoni mirësinë e Allahut mes jush kur ju ishit armiq me njëri-tjetrin. Ai i lidhi zemrat tuaja me njëra - tjetrën dhe ju me mirësinë e Tij u bëtë vëllezër”.

A nuk është e vërtetë se, që në ditët e para të thirrjes islame, Pejgamberi (a.s) vuri paqe mes banorëve të Mekës?

A nuk është e vërtetë se kudo, ku përhapet thirrja e Islamit bashkë me të është edhe paqja në mesin e njerëzve? A nuk është e vërtetë se Pejgamberi (a.s) në fjalimin e lamtumirës fali edhe gjakun e axhës së tij? Bëri thirrje që njerëzit të pajtohen me njëri - tjetrin! Nga këtu e

MOS E HUMB KËTË NJERI NË JETË!

marrim guximin, sa herë që dëgjojmë se në mesin e dy familjeve muslimane ka ndodhur vrasja, gjakderdhje; ndërhyjmë për t'i pajtuar, që vëllavrasja mos të përhapet më tepër!

Subhanallah! Edhe nëse është në fund të botës, muslimani e rrezaton mirësinë e Allahut (xh.sh)! Këtë mirësi për të cilën Allahu (xh.sh) na tërheq vëmendjen dy herë brenda një fjalie, që është: “Përkujtoni mirësinë e Allahut ndaj jush!”, pra është udhëzimi juaj në Islam dhe mirësia e të jetuarit brenda Islamit si vëllezër. Na tërheq vëmendjen me fjalën “nimet”; të jetosh vëllazërinë islame është nimet i madh! Kjo vëllazëri lind këtu dhe e kalon cakun e jetës së ngushtë të një personi. Pra, vëllazëria islame është dhe më e madhe se sa të përkufizohet me jetën e ngushtë të njërit prej nesh, 60 vjet, 70, 80, më pak a më shumë. Vëllazëria tek ne në Islam lind në momentin që ti e ke pranuar Islamin dhe tjetri, që është përpara teje është vëllai yt. Kjo vëllazëri, sa më shumë që forcohet në këtë botë, jep frytet e saj edhe pas largimit tënd prej saj dhe në jetën e përtejme në veçanti.

Në jetën tjetër, Allahu (xh.sh) na tregon se, atë ditë njeriu do të largohet nga nëna e tij, nga baba i tij, nga bashkëshortja e tij, nga djali, nga vajza, nga vëllai, nga motra. Të gjithë janë të alarmuar.

Atë ditë ka vetëm vëlla në Islam. Atë ditë do të të vijë në ndihmë vetëm vëllai yt musliman!

Prandaj ta shohim marrëdhënien tonë që kemi me njëri-tjetrin. Imam Euzaui ka një fjalë shumë interesante që lidhet me normën e vëllazërisë tek ne, thotë: “Shoku për shokun tek ne në Islam është si arna në rrobë. Nëse nuk është e të njëjtit material, e shëmton atë!” Keni parasysh, sikur të kemi një arnë dhe të jetë një ngjyrë tjetër. Ajo si ngjyrë është e bukur, por nëse e arnojmë të bardhën me ngjyrën tjetër, ajo e shëmton atë. Të gjithë do të thonë

çfarë është ajo shenjë aty?! Ku i ka pasur sytë, ose çfarë i ka thënë mendja?!..

Prandaj, duhet të kemi kujdes të mos bëhemi si arna të ndryshme me një rrobë, që sado që e mbulon atë, e shëmton!

Muslimani kurrë nuk e shëmton vëllanë e tij musliman, nuk e pret në besë, nuk e tradhton, nuk komploton kundër tij, madje edhe në shitblerje, nuk punon kundër vëllait të tij musliman! Në momentin që hyn smira, atëherë fillon dhe verbohët njeriu dhe verbohët marrëdhënia në mesin tonë!

“

PEJGAMBERI (A.S) E KA BËRË ELEMENT TË PLOTËSIMIT TË BESIMIT TONË SAKTËSINË E VËLLAZËRISË DHE NDJESISË QË KEMI PËR NJËRI-TJETRIN. “NUK KA ARRITUR NË LARTËSINË E BESIMIT NDOJËRI NGA JU, DERISA TË DOJË PËR VËLLANË E TIJ ATË QË DËSHIRON PËR VETEN E TIJ!”

Të dashur dhe të shtrenjtë!

Ju thashë se vëllazëria tek ne në Islam e ka rrezatimin e saj edhe pas vdekjes. Dëgjoni këtë transmetim të Abdullah ibn Dinarit, i cili thotë: Po ecja një ditë me Hz. Abdullah ibn Omerin, djalin e Hz. Omerit, Abdullahun (r.a) dhe papritmas takuam një nomad në rrugë. Hz. Abdullah ibn Omeri e përshëndeti atë dhe me dashamirësi e përqafoi. I dha kalin e tij për të hipur në të, hoqi edhe çallmën e tij dhe ia vendosi mbi kokë. Unë i thashë: “Allahu të ruajt! Çfarë bëre kështu?! Këta janë nomadë dhe nomadët kënaqen me pak. Nuk ishte e nevojshme

t'i bëje gjithë këtë nderim!”

Ai m'u përgjigj: Babai i këtij ka qenë mik i babait tim dhe unë e kam dëgjuar Resulullahun (a.s) duke thënë: “Prej formës më të lartë të respektit ndaj prindit është që njeriu ta ruajë marrëdhënien e mirë me miqtë e prindit të tij”.

Vëllazëria islame na e ruan dashamirësinë dhe respektin edhe pas vdekjes në këtë botë! Prandaj ta keni parasysh marrëdhënien që kemi me njëri-tjetrin dhe ta forcojmë këtë marrëdhënie, jo për interesa të kësaj bote kalimtare, por të mendohejmë që edhe gotën e ujit kur ia japim tjetrit, ta bëjmë nijet që t'ia japim për hir të Allahut. Të fitojmë kënaqësinë e Zotit tonë dhe të themi *unë këtë njeri e dua për hir të Allahut e çdo gjë të mirë që përpiqem ta bëj, e bëj për hir të Allahut (xh.sh).*

Pejgamberi (a.s) e mësoi një djalë të ri që erdhi pranë tij dhe tha: Ja Resulallah! A e sheh filanin?

- Po.
- E dua për hir të Allahut!
- Shko thuaja!

Muslimani me muslimanin janë në një vijë. Nuk ndërhyjnë shejtani në mesin e tyre. Duhet të përpiqet gjithsecili nga ne që të mos e lejojë shejtanin për të ndërhyrë në frekuencat tona, sidomos për interesat e kësaj bote.

Është transmetuar tek Imam Bejhakiu, kjo fjalë e Pejgamberit (a.s): Kërkoni për vëllezër të sinqertë, njerëz të mirë, burra të mirë, që nuk gënjejnë, nuk mashtrojnë, që nuk janë të haramëve e as thashethemeve. Kjo vlen për burrat dhe për gratë. *Sa më tepër që e pastrojmë shoqërinë tonë nga ligësitë, aq më tepër lartësohet cilësia e marrëdhënieve në mesin tonë dhe aq më tepër përmirësohet cilësia e vetë jetës në mesin tonë.*

Kërkoni për vëllezër të sinqertë! Ata janë zbulurim në mirëqenie. Ata janë imunizim për ty, mburojë për ty nga çdo bela, nga çdo ligësi e nga çdo e papritur.

Në një moment të vështirë ti ke nevojë të trokasësh në derën e dikujt. Mirëpo kujt t'i biesh sot në derë? Kur njerëzit nuk i hapin më derën askujt. Sot, as nuk po hapen dyert, as nuk po kthehet më ai që erdhi të kërkonte ndihmë e të thotë faleminderit, dhe në shumë raste edhe ta harrojë atë derë, të cilës i ka rënë në një moment të vështirë. Pejgamberi (a.s) tha: “Nëse ndonjëri nga ju bie në rrugë të Allahut, (shehid), pastaj i jepet mundësia dhe

ringjallet. Sërish bie shehid dhe pastaj i jepet mundësia dhe ringjallet dhe përsëri bie shehid, por ka borbhe, **nuk do të hyjë në xhenet!”**

Të dashur dhe të shtrenjtë!

Vëllai i mirë, miku i mirë, është bekim nga Allahu (xh.sh), mirëpo ashtu siç e duam për veten tonë ndihmën, duhet të mendojmë që edhe ta japim atë. Prandaj Pejgamberi (a.s) e ka bërë element të plotësisë së besimit tonë saktësinë e vëllazërisë dhe ndjesisë që kemi për njëri-tjetrin. “Nuk ka arritur në lartësinë e besimit ndonjëri nga ju, derisa të dojë për vëllanë e tij atë që dëshiron për veten e tij.”

Allahu (xh.sh) na ka cilësuar si vëllezër, besimtarët janë vëllezër. Atëherë s'ka pse të ketë dhe nuk duhet të tolerohet që në mesin tonë të ketë inate, smira, përçarje! Nuk ia vlen të humbim diçka të shenjtë dhe të madhe që na sjell dobi në këtë botë dhe në të përtejmen për një interes kalimtar dhe banal të kësaj bote që do të shuhet një ditë!

I lutem Allahut (xh.sh) të na bëj nga ata që jetojnë me dinjitet dhe me krenari dhe e shijojnë harmoninë dhe vëllazërinë në mesin e tyre. Kudo që të jemi, jemi vëllezër! Shkoni në Umre dhe në Haxh dhe shihni nga raca, kombe, vende dhe shtete që ndoshta nuk ja keni dëgjuar as emrin, mirëpo në një moment të caktuar aty në tavaf, apo në Arafat, apo në vizitën e Pejgamberit (a.s), shihemi dhe i qeshim njëri-tjetrit. Ka një emërues të përbashkët: namazi, selami, salavati, bamirësia, dashamirësia, solidariteti: VËLLAZËRIA E SHENJTË ISLAME.

Ne nuk e dimë gjuhën e njëri-tjetrit. *Ju u bëtë me urdhrin e Allahut dhe bekimet e Tij vëllezër!* Dhe këtë vëllazëri e ka vulosur Allahu (xh.sh). I ngrati ai që e gris vulën e Allahut. I lumi ai që e shijon këtë mirësi të Allahut në përditshmërinë e tij dhe i lumi ai që i mëkon fëmijët e tij për t'i dashur bashkëmoshatarët e tyre si vëllezër, për hir të Allahut, për dashurinë e Tij dhe dashurinë e Pejgamberit (a.s).

Kështu, ky Islam zhvillohet! Kështu, ky Islam ec përpara. Nga lindja në perëndim jemi një! Kur të jemi një, nuk ka forcë të ligësisë, edhe po të bëhet bashkë, që i del përpara bardhësisë dhe mirësisë dhe bekimeve të Allahut mbi ymetin Islam.

Allahu ju dashtë dhe ju bekoftë!

Diktoi: **Siditë Hafizi**



Dr. Ahmed Et-Tajjib
Shejhul-Ez'her Esh-Sherif

“

SOT FESTOJMË LINDJEN E ZOTËRISË SONË, MUHAMMEDIT (A.S) TË DËRQUARIT TË NJERËZIMIT DHE MËSHIRËS SË ALLAHUT PËR BOTËT, DHE PËR MESAZHIN E TIJ, I CILI DO TË EKZISTOJË – AQ SA TË EKZISTOJË NATA DHE DITA – FENER I NJERËZIMIT DHE DRITA E TIJ, QË I UDHËZON, QË UA SAKTËSON UDHËTIMIN, SA HERË QË HUMBIN RRUQËN DHE U DALIN PENGESA!

”

MYFTIU SYTARI: “DITA BOTËRORE E PAQES, FRYMËZIM PËR T’U NDARË NGA HARAMET DHE ZULLUMET!”

MESAZHI I MYFTIUT TË SHKODRËS, IMAM MUHAMED B. SYTARI, ME RASTIN E DITËS BOTËRORE TË PAQES

Mendoja se kjo tollovi dhe gjurulldi do të mbyllej një herë e mirë në Shkodër, por ja që parashikimi im i heshtur paska qenë i gabuar!

Imagjino, sa tribuna fetare e ligjërata, takime zyrtare, konferenca shkencore ndërjetare me vlerë, fushata të mbara sensibilizimi në bashkëpunim me policinë, me shkolla etj, për të udhëzuar opinionin kundër alkoolit, drogës, bimëve narkotike e të ngjashme dhe, papritur, krejt papritur, “Festa e birrës” që don të imponohet si traditë primitive në mesin tonë!

E lhamdulilah, unë jam musliman dhe bota është më e sigurt! Kjo është esenca dhe zanafilla!

Pas çdo namazi, ne si muslimanë lexojmë dhikret e virdeve ditore që na i mësoi Resulull-llahu (a.s), ku fjalja e parë pas istigfarit është: “All-llahumme Entes-Selamu ve minkes-Selam...”, që do të thotë: “Zoti im, Ti je burimi i Paqimit, prej Teje buron Paqja...”!

Me pak fjalë, më e pakta, pesë herë në ditë, Islami na edukon e na frymëzon drejt paqimit dhe rrugëve të tij, duke u lartësuar ditë pas dite drejt asaj që Krijuesi ynë kërkon prej nesh në këtë jetë!

Le të punojmë me sa të kemi mundësi për të jetuar në paqe dhe harmoni me njëri-tjetrin, duke ruajtur mbi të gjitha dinjitetin dhe krenarinë e besimit dhe të fesë, shenjtërinë e jetës dhe atë të njeriut-mëkëmbës i Zotit në tokë, dijes dhe arsimimit!

Të përpiqemi për të punuar me pastërti e dinjitet, të angazhohemi për të ruajtur e mbrojtur Tokën, nënën tonë të përbashkët, nga zjarret dashakeqe, nga shkatërrimet egoiste, nga zaptimet zullumqare, nga mohimi i pronësisë për të zotët legjitimë, por jo vetëm, dhe që shpien drejt konflikteve dhe të papriturave të padëshiruara!

Të angazhohemi me të gjitha forcat për t’u ndarë nga politikat shkatërrimtare, që prishin rendin mbi tokë, edhe duke përdorur kartën e fesë për të përçarë njerëzit mbi baza fetare, si një gangrenë e keqe, që është

instaluar në mendësitë provinciale të mbështetura edhe nga rrogatë meskinë!

Të japë secili diçka nga vetja e tij për paqen me dinjitet, duke falur mirësi e dashuri, mirëkuptim e heshtje, sidomos në familje, me fëmijët, me të rinjtë e farefisin!

Nuk mund të prodhojmë paqe sociale, duke mbështetur “festat” e harameve, duke promovuar alkoolin, lakuriqësinë, devijimet morale dhe injorancën, në zemër të lagjeve tona dhe bri shtëpive të Zotit!

Rini e alkoolizuar, e droguar, rini hashashi, banalitetesh, nuk mund të jetë ajo që e themi në zhargonin e përditshëm: “e ardhmja e kombit”!

Alkool, zhurmë e çmendur deri në orë të vona, shëtitorja kryesore e qytetit e mbushur me flamuj me shishe birre, harbim para dymëve të Bashkisë, nuk është as më shumë e as më pak sesa një shfaqje e denjë për njerëz pa dinjitet, “pa din e pa iman”, siç e përmend shpesh edhe kryeministri i vendit!?

Mendoja se kjo tollovi dhe gjurulldi do të mbyllej një herë e mirë në Shkodër, por ja që parashikimi im i heshtur paska qenë i gabuar!

Imagjino, sa tribuna fetare e ligjërata, takime zyrtare, konferenca shkencore ndërjetare me vlerë, fushata të mbara sensibilizimi në bashkëpunim me policinë, me shkolla etj, për të udhëzuar opinionin kundër alkoolit, drogës, bimëve narkotike e të ngjashme dhe, papritur, krejt papritur, “Festa e birrës” që don të imponohet si traditë

primitive në mesin tonë!

Sapo mbaroi java e parë e fillimit të vitit të ri shkollor. Para Bashkisë mund të shihnim një panair libri, një festival të letërsisë për fëmijë e të rritur, një fushatë sensibilizuese për leximin, shenjtërinë e librit, një seri mbrëmjesh letrare e poetike me shkrimtarët dhe poetët më me zë të qytetit e përtej, duke i mbështetur e vlerësuar, një panair të arritjeve të talenteve të Shkodrës në dije e shkencë, një..., por...!?

Nuk mund të ketë paqe, nëse nuk e kultivojmë dhe e jetojmë atë në familje fillimisht, pastaj në rrethin e ngushtë familjar, e më pas në shoqëri, me shumë kujdes e plot përkushtim, duke ndjekur dritën e Zotit dhe udhëzimin e Tij, jo interesat e ngushta, tekat e skutat e errëta!


Fjala e mirë është paqe! Buzëqeshja e sinqertë është paqe! Heshtja e urtë është paqe! Mësimi dhe edukimi i udhëzuar është paqe! Ndihma në rast nevojë është paqe! Luftimi i së keqes në jetë është paqe! Kundërshtimi i keqpërdorimit të besimit është paqe! Përballja me tërë fenomenet e prishjes dhe devijimit është paqe!

Paqe me Zotin! Paqe me robin! Paqe me vetveten e me realitetet e përditshme, që gjithsesi mbeten më të dobëta sesa mundësia për të ndryshuar kaderin!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

Shkodër, më 21 shtator 2023



Prof. dr. Bajram Xhafa, historian

Aty nga vitet '60 të shekullit të kaluar, Temo Selhani, shegert në furrën e Malo Karinit, në po atë furrën e dikurshme të Musa Karinit qysh nga koha e Muaseres, ulur mbi një thes mielli më tregonte një episod “nga lufta” me Malin e Zi. Pasi kishte mbaruar beteja në Bardhaj, në Lodër Tunë, nga Kodrat e Rencit, ku kishte marrë pjesë dhe ishte vlarë Musa Karini “i Parë”, Temoja kishte tërhequr trupin e tij pa kokë, të cilën malazezët ja kishin hequr.

SI KISHTE NISUR NGJARJA?

Ishte koha e Muaseres, ai Rrethimi i gjatë 7 mujor i Shkodrës në vitet 1912-1913 nga ushtritë malazezo-serbe në përpjekje për ta pushtuar. Një rrethin i tmerrshëm, i gjatë, që s’kish të mbaruar, me sulme të tërbuara, por edhe me kundërsulme po aq të vendosura, pa e luajtë këmbën një thembër mbrapa, një mbrojtje mbinjerëzore, e jashtëzakonshme.

Një ditë në mëhallën Rus vjen një

RA SHEHIT TURKU, PËR SHKODRËN

(Një episod nga Rrethimi i Shkodrës më 1912 – 1913)

Ishte koha e Muaseres, ai Rrethimi i gjatë 7 mujor i Shkodrës në vitet 1912-1913 nga ushtritë malazezo-serbe në përpjekje për ta pushtuar. Një rrethin i tmerrshëm, i gjatë, që s’kish të mbaruar, me sulme të tërbuara, por edhe me kundërsulme po aq të vendosura, pa e luajtë këmbën një thembër mbrapa, një mbrojtje mbinjerëzore, e jashtëzakonshme.

kompani suvari (kalorës). Komandanti i saj, oficer turk, një burrë i gjatë biond, i bën thirrje dugajxhinjëve të Rusit për t’u nisur në luftë. Pas kësaj, hipur mbi kalë, i qetë e krenar, me një shprehje në fytyrë ku shihej siguria dhe vendosmëria, nxori nga xhepi një krehër dhe një pasqyrë dhe filloi të krihet e të rregullohet sikur të bëhej gati për ceremoni martese apo për të shkuar në ndonjë eveniment publik. Ndërkaq del një dyqanxhi dhe bën një “kundërthirrje”. - Mos gaboni, mos i shkoni mbrapa këtij horri e pushti! A nuk e shihni se si krihet e lëpihet si një fodull? Oficeri turk kishte heshtur, nuk i kishte kthyer përgjigje sfidantit, por me qetësi ishte larguar pa thënë asnjë fjalë.

I bërë flakë nga nervozizmi dhe i revoltuar në kulm nga fjalët e bashkëqytetarit të tij, Musa Karini del përpara dhe u thotë atyre që ishin mbledhur: - Mos i veni vesh fjalëve të tij sepse ky nuk din gjá. Ky që sapo u largua është myslimani vetë (myslimani i vërtetë), dhe drejtoi gishtin nga oficeri turk, sepse myslimani i mirë para se të shkojë në luftë merr abdes, lahet e

pastrohet mirë, rregullohet dhe pastaj niset, sepse ai bahet gati me ra shehit (dëshmor). Me të thënë këto fjalë Musa Karini, nga dyqanet dolën 20 dugajxhi (dyqanxhinj) shkodranë dhe u nisën për në Bardhaj, në frontin e luftës. Nga fjalët e tij ka dalë kënga: “Ka ardhë dita kush asht shqiptar, / Shkodran mysliman, / Me Karadakun ta bajë bejanë”.

Në këtë rast janë vlarë 12 rusianë si: Ali Gramshi, Musa Karini, Rustem Gerçari, etj. Trupi i Musasë u gjet i vlarë në rreshtin e tretë, me kokën të prerë e të hedhur veçmas trupit. Duke kërkuar më tej, thellë midis radhëve të ushtarëve malazezë të vlarë, dukej trupi i pajetë i oficerit osman të qëndronte i mbështetur pas një shkëmbi. E njohën nga larg tek dukej ashtu i krehur si një monument martiri. Me guxim të jashtëzakonshëm u kishte dalë t’u bjerë nga pas forcave malazeze, por aty kishte rënë midis tyre duke luftuar si luan. Dhe ra shehit turku,... për Shkodrën, për vllaznit në Islam.

(Treguar nga Lutfi Musa Kalçi Shkodër, korrik 2005)





Mr. Muhidin Ahmeti
(1962 - 2018)

Tokën e kishte shndritur drita e Zotit me ardhjen e njeriut të parë Ademit dhe gruas së tij Havvas, me detyrën që të jenë bartësit e porosisë dhe ligjit të Tij të lartësuar. Ajo dritë u përçoll larg e më larg, nëpër shekuj dhe epoka. Nganjëherë ajo dritë pakësohej, herë -herë binte nën hije e nganjëherë ndriçonte fuqishëm.

Kështu vazhdoi mijëra vite derisa erdhi Pejgamberi i fundit, Muhammed (a.s), kur drita e Zotit vjen në Tokë me tërë fuqinë dhe bukurinë e saj.

Të gjitha melaqet përgjonin urdhëresën e All-llahut, që të shihnin kush është ajo krijesë dhe çfarë do të bëhet?

Para 1431 vitesh, me 12 Rebiul -evvel – 20 Prill 571, një dritë e fuqishme e shndriti planetin tonë Tokën, dritë (nur) prej së cilës u shkatërruan 14 kullat e mbretit të Persisë Kirsaut, dritë nga e cila u fik zjarri që e adhuronin zjarrputistët më mijëra vite në Indi dhe Persi, dritë e cila shndriti tërë shtëpinë e Abdullahut në Mekke dhe nga atje u shpërnda duke ndriçuar pallatet e Shamit – Sirisë së atëhershme. Çdo gjë paralajmëronte se në këtë botë po vjen krijesa më e zgjedhur e All-llahut, robi më i mirë dhe më fisnik i Zotit, krenaria e gjithësisë, i cili për mision do të ketë që njerëzimin ta nxjerr nga terri në dritë. Me vetë lindjen e tij, Pejgamberi paralajmëroi misionin e tij. U shkatërrua çdo gjë që madhërohej dhe adhurohej përveç All-llahu (xh.sh).

Kur lindi ky fëmijë babai i tij tashmë kishte vdekur. Nëna Emine e lindi vetëm dhe sikur secila nënë kujdesej dhe brengosej se çfarë do të ndodh me të. E Ajo as që ishte e vetëdijshme se ka lindur njeriun, i cili do të trondit tërë botën, i cili do ta ndërrojë rrjedhën e historisë, i cili do ta rilindë gjininë njerëzore, i cili në mënyrë konstante do

MUHAMMEDI (A.S) KRENARIA E GJITHËSISË!

Në përkujtim të ditëlindjes së Pejgamberit (a.s)

“Dhe Ne, ta ngritëm lart famën tënde!”

(Kur'ani, El Inshirah: 4)

ta lëvizë botën parapara, do t'i japë fund idhujtarisë dhe adhurimit të idoleve, i cili do ta shpjerë njeriun në një rrugë të re, do t'i ofrojë botës një vizion dhe kuptim të qartë, të arsyeshëm dhe të qëndrueshëm për njeriun dhe gjithësinë deri në fund të saj; lindje kjo që nga njerëzit e paarsyeshëm, obskurrantë dhe fanatikë të luftës do të bëjë njerëz fisnikë, të cilët do të jenë të gatshëm të sakrifkohen për jetë dhe të aplikuar në jetë drejtësinë, humanitetin dhe të mirën e përgjithshme. Ky njeri do të jetë ai i cili do t'u sjell njerëzve fjalët e All-llahut, i cili do të ndajë të vërtetën nga e pavërteta, të mirën nga e keqja, drejtësinë nga padrejtësia, emri i të cilit do të përmendet edhe pas vdekjes së tij, pjesëtarët e të cilit do të jenë aq shumë si shkuma e detit, të cilët do të jetojnë dhe vdesin me emrin e tij në gojë deri në ditën e Kiametit.

Pejgamberi rritet duke mos e parandie se me çfarë barre do të jetë i ngarkuar, se çfarë misioni do të ketë, se me çfarë do ta obligojë All-llahu (xh. sh). Tërhiqet në vetmi dhe mendon e mediton...a jemi vetmuar ne ndonjëherë që të mendojmë për All-llahun, për veten dhe gjendjen tonë. Në ato momente të medimitit e ndërpret meleku Xhebrail. Ia sjell fjalët, jo nga kushdo, jo prej ndonjë sunduesi të vogël tokësor, përkundrazi, ia sjell fjalët e sunduesit të shtatë qiejve dhe Tokës, sunduesit të Ditës së, gjykimit, Zotit të gjithë njerëzve, xhinëve, melaqeve, shejtanit, bimëve, kafshëve, sunduesit të çdo gjëje që e shohim dhe nuk e shohim. Ia sjell fjalët prej të cilave copëtohen e thërrmohen malet e kodrat nga frikë-respekti ndaj Tij, fjalë, të cilat as Toka as qiejt nuk e guxuan t'i pranojnë, por i mori për sipër Resulullahu (a.s) që t'ua komunikojë gjinisë njerëzore dhe xhindëve dhe të transmetojë këtë porosi të shkurtër për të rëndësishme: La ilahe ilall-llah Muhammedun Resulull-llah.

Kjo qe një lindje, e cila në mënyrë konstante do ta lëvizë botën, do të rrënojë themelet e xhahilijetit, do të nxjerrë njeriun në një rrugë të re, do t'i japë botës një alternativë të re për

shpëtimin e njerëzimit. Lindje e cila do ta rilind botën duke i dhuruar asaj atë strukturë shpirtërore, që do ta përcjelle njeriun deri në fund të botës e edhe pas saj. Lindje që do të instalojë norma të reja të rregullimit të marrëdhënieve brenda shoqërisë së re dhe do të vendos rendin e ri botëror, i cili për bazë do të ketë monoteizmin e paprekshëm që do të vazhdojë deri në ditën e Kiametit.

Muhammedi (a.s), pra, është ai të cilin All-llahu e dërgoi më udhëzim të qartë. Dhe nuk është për t'u habitur që disa ngritën krye, sepse ishin të vetëdijshëm se po vjen koha e vendosjes së kriterëve tjera të vlerave njerëzore, vlera të cilat themeloheshin dhe bazoheshin mbi parimet e besimit, i cili quhej, quhet dhe do të quhet deri në fund të kësaj bote dini Islam – feja e paqes globale dhe mëshirës universale. Për shkak të shkëlqimit të madh të dritës në terrin e madh, në të cilin njerëzit tashmë ishin mësuar të jetojnë, patjetër që kjo ishte befasi jo e këndshme. Nëse njerëzit nuk e kanë një gjë me të cilën janë mësuar të jetojnë, vërehet një lloj konfuzioni tek ata. Shkaktohet konfuzion i fuqishëm, p.sh. tek alkoolisti nëse nuk ka alkool, te varësi i drogës nëse nuk ka drogë, te kumarxhiu nëse nuk ka më kë të luajë kumar, apo nëse nuk ka veprime të tjera të këqija në dispozicion të njerëzve. Në opozitë me gjendjen e këtyllë të njerëzve, ishin ata për të cilët është bërë zakoni të thuhet të dobëtit, të varfrit dhe të pafuqishmit, për ta rendi i ri ishte realizimi i shpëtimin të pritur nga fatkeqësitë dhe padrejtësitë që u bëheshin në vazhdimësi.

Kur po u afrohej të dyzetave Muhammedi (a.s) filloi të jetonte në vetmi, në shpellën e kodrinës Hira, afër Mekkes.

Muhammedin (a.s) e mundonte e keqja që zotëronte në Mekke dhe në tërë Arabinë. E brengoste shpirtligësia dhe korrupsioni që mbretëronin gjithkund. Ai, në kodrinën Hira, në qetësinë e shpellës, në vetminë e plotë, gjente prehjen e vet. Me orë të tëra sodiste horizontet e gjëra, kaltërinën e qiellit gjatë ditës dhe shkëlqimin e yjeve në

errësirën e natës. Thellohej në shpirtin e natyrës nëpërmjet barit e luleve, nëpërmjet ecjes së thneglave, duke e soditur merimangën që endte pëlhurën e rrjetës së saj, duke e soditur zogun në fluturim. Muhammedi (a.s) filloi gradualisht t'i afrohej së vërtetës, të cilën ende nuk e njihte dhe të cilën ende nuk mund ta kuptonte. Shpirti i tij i madh dhe fisnik përgatitej që të pranonte Njohuri të Gjëra, Diqe të sigurt, Zbulimin e perdes nga Fshtehtësia e Madhe. Kjo ishte dëshira e All-llahut (xh.sh).

Dhe një natë, në vigjilje të ditës së njëzet e shtatë të muajit Ramazan, para Muhammedit (a.s) që meditonte i thelluar në mendime të thella, përnjëherë vetoi drita, u shndrit shpella.... Muhammedi (a.s) u dridh, çoi duart që t'i mbyllte sytë. Drita u shndërrua në figurë.

Muhammedi (a.s) i dëgjoi qartë zërin që dilte nga thellësia e shpellës: “O Muhammed, i biri Abdullahut! Unë jam meleku Xhibril, po të sjell nga All-llahu, Zoti i Gjithësisë, Lajmin e Gëzueshëm se je zgjedhur Pejgamber i All-llahut”.

Pastaj, më i miri i melaqeve Xhibrili (a. s) ia shpalli fjalët e para që i erdhën nga qielli, nga Zoti dhe Krijuesi i Gjithësisë:

“Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirbërsit!”

“Lexo dhe mëso...”

“Lexo, me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi çdo gjë”.

Ky ishte zbulimi i All-llahut që ia frymëzoi shpirtin e tij të etur sikurse shiu që bie pas një thatësie të gjatë dhe e ngjallë tokën e vdekur.

Arriti të njoh të Vërtetën Absolute dhe nga ajo befasi mahnitëse, nga ai përjetim i jashtëzakonshëm, nga ajo tronditje iu deshën tre vjet që të stabilizohet për të vazhduar misionin e tij. Cili është hapi i parë që duhet bërë pasi të njohësh të vërtetën. Komunikimi, kumtimi dhe publikimi. Atëherë erdhi lajmi tjetër:

“O ti i mbuluar qohu dhe tërhiqja atyre vërejtjen.” (El-Muzemmil 1-4)

Tani detyra e tij ishte që ta transmetojë dhe shpjegojë teorikisht dhe praktikisht. Tani fillon koha e realizimit dhe aplikimit në jetë e Fjalës së All-llahut (xh.sh). Koha e realizimit të Fjalës së Zotit (xh.sh) në histori, në fjalë të gjallë dhe libër të gjallë. Koha e vendosjes përfundimtare të islamit në histori.

Në këtë periudhë fillojnë sfidat dhe bashkë me to edhe kalitja dhe formimi i karakterit në personalitetin e të dërguarit Muhammed Mustafasë. Kjo kulmon me sfidën dhe joshjen me provokuese për shpirtin e njeriut të zakonshëm, por jo edhe për shpirtin e pejgamberit, i cili në ofertën e mushrikëve për pasuri, pushtet, autoritet dhe për privilegjet më të mëdha të kësaj bote, si zëvendësim që ai të braktis misionin e tij të ngarkuar nga Zoti, ai përgjigjet:

“Beto hem në All-llahun se sikur të vendosnin diellin në krahun tim të djathtë dhe hënë në krahun tim të majtë, që të braktis këtë mision timin, nuk do ta bëja dot, derisa All-llahu ta qet në shesh atë apo unë të flijohem për të.”

Sepse privilegjet që ia dha Krijuesi i gjithësisë ishin ato që po e përgatiteshin për misionin e madh të drejtimit të botës.



Shikojeni inkurajimin, fuqizimin gradual dhe kalitjen e jashtëzakonshme që ia bënte All-llahu (xh. sh:) të dërguarit të Tij:

“Dhe Ne, ta ngritëm lart famën tënd.” (El Inshirah: 4)

1. Zoti ia hapi dhe ia pastroi gjoksin: “A nuk ta hapëm Ne gjoksin tënd?” (El-Inshirah: 1)

2. Zoti ia hoqi barrën: “Dhe Ne hoqëm prej teje barrën tënde, e cila shtypte shpinën tënde.” (El-Inshirah: 2,3)

3. Zoti nuk e braktisi dhe as nuk e përbuzi: “Zoti yt as nuk të ka lënë, as nuk të ka përbuzur.” (Ed-Duha:3). “Botën e amshueshme ia bëri shumë më të mirë se kjo botë.”

4. Zoti i dha dhe e bëri të kënaqur: “E Zoti yt do të japë ty, e ti do të kënaqesh.”

(Ed-Duha:5)

5. Zoti e strehoi dhe e mbrojti: “A nuk të gjeti ty jetim, e Ai të dha strehë.” (Ed-Duha:6)

6. Zoti e udhëzoi atë: “Dhe të gjeti të paudhëzuar e Ai të udhëzoi.” (Ed-Duha:7)

7. Zoti e pasuroi dhe begatoi: “Dhe të gjeti të varfër e të pasuroi.” (Ed-Duha: 8)

8. Zoti ia dha kevtherin: “Ne, vërtet të dhamë ty shumë të mira (Kevtherin).” (El-Kevther: 1)

9. Zoti ia pastroi gjuhën: “Ai nuk flet nga hamendja.” (En-Nexhm: 3)

10. Zoti ai pastroi zemrën: “Zemra nuk e përgënjeshtroi atë që pa.” (En-Nexhm: 11)

11. Zoti ia pastroi memorien dhe mbamendjen: “Ne do ta lexojmë ty e nuk do ta harrosh (Kur'anin).” (El-Ala: 6)

Pejgamberi rritet në një shoqëri e cila ishte bërë sinonim për çdo shoqëri të keqe, amorale dhe primitive që i gjejmë në të gjitha kohët dhe hapësirat, siç kemi sot shoqërinë e xhahilijetit modern.

Të folurit e Pejgamberit ishin fjalime jo të zakonshme dhe ato hasnin në kundërshtime të mëdha, sepse për synim kishin ndërrimin e njeriut dhe transformimin e shoqërisë. E çdo fjalim që pretendon ta ndërrojë njeriun dhe shoqërinë, patjetër që do të hasë në pengesa dhe vështirësi, do të hasë në persona të tillë, të cilët me veprimet e tyre bëhen pjesë e problemit e jo pjesë e zgjidhjes. Vështirësitë, pengesat dhe sfidat në rastet e këtylla janë

të natyrshme, sepse një ide që është në kokën e një njeriu duhet materializuar dhe transformuar në praktikë të gjallë jetësore. E për të realizuar këtë më parë duhet ndërruar sistemi i të menduarit dhe për të bërë këtë duhet t'i drejtohem, jo vetëm arsyes logjike të njeriut, por edhe zemrës së tij. Vetëm nëpërmjet trajtimit të saktë të mendjes dhe zemrës, mund të ndodhin ndryshime në qëndrimet e njerëzve.

Karakteristika e Kur'anit është pikërisht kjo, që i drejtohet njëkohësisht edhe zemrës edhe mendjes.

DËSHMITARË I TË MIRAVE DHE KUMTUES I LAJMIT TË GËZUAR

Ai është Lajmëtar i fesë, i cili është dërguar që të jetë si kumtues i lajmit të gëzuar, por edhe të paralajmërojë

njeriun që të mos bëjë të liga pas të cilave vijjnë lajme të këqija. Kjo është ashtu për arsye se All-llahu ia mundësoi Pejgamberit Muhammedit (a.s.) që të jetë pishtar që bën dritë. Prandaj edhe i është thënë: “Përgëzoi besimtarët dhe thuaju që All-llahu i lartësuar i do ata, prandaj edhe i përfshin me mëshirën e Vet. E ata të cilët këtë nuk e shohin dhe mos u vë veshin atyre, të cilët janë jo mirënjohës. Mbështetu te All-llahu, Atë e ke mbrojtës të mjaftueshëm.”

Dashurinë e All-llahut si mëshirë ne e ndiejmë çdo moment, sepse pa të as syrin, as gishtin, as dorën, as këmbën nuk do të mund ta lëviznim. Dhe çdo moment ne dëgjojmë lajmin e gëzuar, sepse pa të as sytë nuk do të mund t'i mbyllnim prej halleve, as shpirtin ta çlironim nga shtrëngimet e dynjasë, as mendjen ta lironim nga dyshimi në jetën që na ofrohet si dhurata e Zotit, si shkëlqim i pishtarit të Pejgamberit që na ndriçon në këtë muaj të bukur të lindjes së tij, të mevludit të tij, të cilin ne këtu e përjetojmë në mënyrë të veçantë si shprehje e falënderimit ndaj Zotit që na e ka bërë të dashur Pejgamberin e Tij Muhammedin (a.s.) dhe të mundur që në mevludet tona ta përmendim me besimin dhe shpresën që ai, Pejgamberi ynë, selamet dhe slavatet qofshin gjithmonë për të, do të na njohë në ditën e gjykimit dhe do të na ndihmojë atje me shefaatin e tij, që të kalojmë përmbi atë lum, mbi të cilin është ajo urë që është më e hollë se qimja e flokut, e më e mprehtë së tehu i shpatës.

E që Pejgamberi ynë të na njehë atje, ne duhet atë ta njohim këtu, sepse shkathtësinë për ta kaluar lumin përmbi urën, e cila është më e hollë se qimja e më e mprehtë se shpata, duhet ta mësojmë këtu, në Këtë botë. Prandaj, ai që e dëgjon dhe e ndjek mësuesin, i cili mëson si duhet ecur që të mos rrëzohet dhe si duhet jetuar që të mos zhytët në llumin e kësaj bote, mund të pres që edhe atje do të dijë me sukses të kalojë nëpër havdi kevther deri të hyrja e xhennetit.

E mësuesi ynë është Muhammedi (a.s.) në dorën e të cilit është pishtari (kandili ndriçues) që na ndriçon rrugën (siraxhen munira). Prandaj lindja e tij është e rëndësishme e prandaj edhe është e rëndësishme të përkujtojmë disa gjëra pikërisht në ditën e mevludit të tij, sepse po të mos ishte lindja e tij, në nuk do të dinim kush është Krijuesi ynë, e as kush është Furnizuesi ynë, nuk do të dinim prej nga është fillimi, as prej kujt vjen fundi, nuk do të dinim kush është

babai ynë, as kush është nëna jonë, nuk do të dinim prej nga kemi ardhur dhe ku do të shkojmë, nuk do të dinim përse jemi këtu, dhe ç'na pret atje, nuk do të dinim prej nga është as kënga e zogut, nuk do të dinim ç'është e mirë, as ç'është e bukur, nuk do të dinim të përqafonim nënën, as të donim babain.

Po të mos kishte lindur ai, Pejgamberi ynë, ne nuk do të dinim dallimin midis besimit dhe jo-besimit, nuk do të dinim dallimin midis të mirës dhe së keqes, nuk do të dinim dallimin midis dashurisë dhe urrejtjes, nuk do të dinim dallimin midis shpresës dhe frikës, nuk do të dinim dallimin midis mikut dhe armikut, nuk do të dinim dallimin midis bashkimit dhe përçarjes, nuk do të dinim kush jemi dhe çka jemi.

Ai, i Dashuri i All-llahut dhe shefatxhiu ynë në ditën e Gjykimit, na ka mësuar që të besojmë në Një Zot të Vetëm, prindërit t'i duam dhe t'u bëjmë mirë atyre, të mbështetemi në vetvete, të bëjmë hajr-dua për njëri tjetrin, të ndihmojmë njëri tjetrin në vështirësi, që fqinji ynë të mos jetë i uritur e ne të ngopur, të vendosim lidhje bashkëshortore, të krijojmë familje, të ngremë xhamia, të lexojmë e të mësojmë, të jemi të dobishëm për njerëzit, të përshëndetemi me buzëqeshje në mes vete, të mos ia zbulojmë njëri tjetrit të metat, të përkrahim njëri-tjetrin në të mirë, të mos i hakmerremi njëri tjetrit, të jemi të butë ndaj njëri -tjetrit, të mos jemi të vrazhdë me njëri tjetrin, sepse atëherë njerëzit do të largohen prej nesh, prandaj dhe duhet t'ia falim njëri tjetrit dhe duhet të kërkojmë falje te Zoti për njëri tjetrin dhe duhet të këshillohemi me njëri tjetrin, e kur të vendosim të bëjmë diç bashkë, atëherë duhet të jemi të vendosur dhe të mbështetemi te All-llahu i Lartësuar, sepse All-llahu i do ata, të cilët mbështeten tek Ai.

NË VEND TË PËRMBYLLJES

Profeti bën përpjekje që të gjithë ata të cilët vijjnë në kontakt me islamit ta ndiejnë që islami është mëshirë, e jo mallkim për njerëzit. Pejgamberi (a.s.) në radhë të parë i shpëton arabët, e pastaj edhe të tjerët nga adhurimi i idoleve prej gurit e drurit dhe i udhëzon në adhurimin e atij që është përjetësisht i Gjallë dhe që nuk vdes kurrë. Çliron robërit nga zgjedha dhe shtypja tiranike, e lartëson jetën njerëzore në vlerën e saj të vërtetë, vendos norma morale dhe të drejta njerëzore, të cilat e rilindin secilin njeri që i merr ato dhe i zbaton në praktikë. Për ta ndjerë cila është

ajo mëshirë që na vjen nga Pejgamberi ynë duhet ta aplikojmë mësimin e tij në jetët tona. Kështu Pejgamberi i All-llahut thotë: “Mos e çoni zili njëri tjetrin, mos e mashtroji njëri -tjetrin, mos e urreni njëri tjetrin, mos ia ktheni shpinën njëri tjetrit duke e ngritur zërin lartë; mos bëni konkurrencë në shitje me njëri tjetrin dhe bëhuni vëllezër të vërtetë o robër të All-llahut. Muslimani për muslimanin është vëlla. Nuk do ti bëjë dhunë, nuk do ta braktisë, nuk do ta gënjejë, nuk do ta poshtërojë. Devotshmëria është këtu. (në gjokse – këtë e përsëriti tre herë). Është e mjaftueshme për një njeri e keqja e poshtërimit të vëllait të vet musliman. Për një musliman janë haram të gjitha gjërat e muslimanit tjetër, jeta e tij, pasuria e tij dhe nderi i tij” (Muslimi). As'habet të cilët jetuan me Pejgamberin e ndien atë mëshirë dhe punuan e luftuan që ajo të vazhdojë edhe më tej deri në ditët e sotme. Edhe ne sot pas gjithë atyre shekujve e përjetojmë atë mëshirë universale të Pejgamberit të Zotit. Pejgamberi (a.s) ka vdekur, por fjalët e tij kanë mbetur të gjalla dhe jetojnë e do të mbetën deri në fund. Kanë mbetur pas tij njerëz, të cilët e dinë që kjo botë mund të jetë më e mirë se është tani, njerëz të cilët e dinë që mëshira e All-llahut lëshohet vetëm mbi ata që cilët e duan All-llahun dhe Pejgamberin e Tij dhe të cilët janë të gatshëm të vdesin për atë misionin e qartë dhe të thjeshtë, të cilin e promovoi dhe të cilit i priu Pejgamberi ynë, e ai është: LA ILAHE IL'LALL-LLAH, MUHAMMEDUN RESULULLAH – NUK KA ZOT TJETËR PËRVEÇ ALL-LLAHUT DHE MUHAMMEDI ËSHTË ROBI I ZOTIT DHE PEJGAMBERI I ZOTIT. I lutemi All-llahut që këto fjalë të jenë njëherazi edhe fjalët tona të fundit me të cilat do ta lëshojmë këtë botë dhe që të takohemi në botën e ardhshme me Resulullahun tonë në xhenet. Amin

Referencat:

1. Hadithe të zgjedhura të Pejgamberit alejhisselam, Tetovë, 2003
2. Dr. Abdurrahman Rafet El Basha, *Fragmente nga jeta e sahabëve* (3), Prishtinë, 1996.
3. Dr. Fuad Sedic, *Posebnosti Muhammeda (s) i njegovog ummeta, Bihaç*, 2005.
4. H. Ismet Spahic, *Hutbe, Sarajevo*, 2000.
5. Zahid Mujkanovic, *Od Masrika do Magriba – Hutbe, Sarajevo*, 1998.
6. Shehibrahimoviq, *Ismet U.:* “Fuqija e besimit-përsosmëri shpirtërore”, *Shkup*, 1983.
7. El-Harun selimovic, *Psihologjia islama, Istanbul*, 1995
8. www.preporod.com/kolumna.asp?id=1
9. www.znaci.com_Sarajevo-BiH_2001_2005
10. www.znaci.com_Sarajevo-BiH_2001_2005
11. <http://www.mm.co.ba>
12. <http://www.icc-selam.org/>

(Marrë nga: www.mesazhi.com)

KATËR MUAJ UDHËTIM ME BIÇIKLETË:


I riu nga Guinea përshkon 6 shtete për të studiuar në Al-Azhar të Egjiptit

FERDI BAYAT

Iriu Muhamed Shafi Bari nga Guinea udhëtoi 5.000 kilometra me biçikletën e tij për të arritur në kryeqytetin egjiptian Kajro dhe për të përmbushur ëndrrën e tij për të studiuar në Universitetin prestigjioz Al-Azhar.

Ky 25-vjeçar u largua nga vendlindja e tij Conakry më 17 maj me dëshirën për të studiuar në Al-Azhar, i cili është një nga institucionet më të vjetra dhe më prestigjioze të arsimit të lartë në botë.

Shafi Bari është i martuar dhe baba i një fëmije dhe dëshirën për të studiuar në Al-Azhar e ka marrë nga ligjëratat frymëzuese të dijetarit Shejhi Muhamed Muteveli Al-Sharavi.



“Mësimi i Kuranit i Shejh Al-Sharaviut, tefsiri i tij (interpretimi i Kuranit) dhe thirrja e njerëzve në besim është diçka që unë dua ta ndjek. Kjo është arsyeja pse vendosa të vij në Egjipt dhe të studioj”, tha Shafi Bari në një bisedë me Anadolu.

Gjatë udhëtimit të tij me biçikletë, Shafi Bari ka udhëtuar nëpër Guinea, Burkina Faso, Togo, Benin, Niger dhe Çad.

“Kishte shumë vështirësi. Kam fjetur vetëm në pyll dhe në kodra. Më së shumti kisha frikë se mos ma vidhnin biçikletën dhe për këtë arsye nuk e lija as kur flija. Kam ngrënë një ose dy herë në ditë dhe ka qenë e vështirë të gjej ujë për t'u larë”, tregon Bari.

- Arrestimi, mbijetesa me fruta, ndryshimi i rutës për shkak të përleshjeve

Ndërsa po pedalonte nëpër Togo, Shafi Bari u ndalua nga forcat e sigurisë atje dhe u mor në pyetje për qëllimet dhe arsyet e udhëtimit.

“Më bënë shumë pyetje. Unë iu përgjigja të gjithave, por nuk arrita t'i bindja. Pas nëntë ditësh më liruan nga paraburgimi dhe prej aty shkova në Benin”, tha ai.

Në Benin ai nuk ka pasur probleme të tilla, por ka pasur vështirësi në gjetjen e ushqimit, ndaj është ushqyer kryesisht me frutat që ka gjetur në pyje.

Shafi Bari nga Guinea mbërriti në Çad për rreth dy muaj me biçikletën e tij dhe iu desh të ndryshonte rrugën për shkak të përleshjeve që shpërthyen në Sudan midis ushtrisë dhe rebelëve.

“Planifikova të qëndroj në Çad për dy javë dhe të vazhdoj udhëtimin tim. Nuk kisha frikë nga përplasjet në Sudan,



sepse erdha nga Guinea në Çad pa asgjë. Mendova me vete, Allahu më ndihmoi për në Çad, kështu që do të më ndihmojë të arrij në Egjipt”, tha Shafi Bari.

Megjithatë, një gazetar që takoi në Çad nuk e lejoi të shkonte në Egjipt nëpërmjet Sudanit, por e ndihmoi të gjente donator, i cili i bleu biletë avioni për një fluturim nga Çadi në Egjipt.

- “Do të kisha ecur nëse nuk do të kisha biçikletë”

Ndonëse në Guine la pas gruan dhe vajzën, Shafi Bari shprehet i lumtur që më në fund pas katër muajsh mbërriti në Kajro dhe plotësoi dëshirën.

“Mbërrita në Egjipt gjallë dhe mirë. Mblodha dokumentacionin e nevojshëm dhe u regjistrova në Al-Azhar. Jam pranuar. Kam ardhur me biçikletë, por edhe të mos kisha, do të kisha ardhur në këmbë”, tha në fund Shafi Bari.

(www.aa.com.tr)



Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Dikush e ka ditur të vërtetën dhe ka neglizhuar të thërrasë drejt saj!

Shpesh mendoj se cili është shkaku i këtij realiteti të ngatërruar e të dhimbshëm, në të cilin jeton si në një labirinth pa krye shoqëria shqiptare, por jo vetëm?

Ka një luftë sistematike kundër identitetit islam, pastërtisë së vlerave, madhështisë së trashëgimisë, tabanit qytetar dhe moralit të pashembullt në marrëdhëniet familjare e sociale, por jo vetëm kaq!?

Përgjigje ka shumë. Mendime ka shumë. Përpjekje për të ndryshuar ka shumë. Lëvizje në drejtimin e duhur ka shumë. Lëvizje me energji të humbura ka shumë. Energji për inat të tjetrit ka shumë. Karshillëk për ego të sëmura provincialësh të rritur në oborre të pamerituara, poashtu ka shumë. Përpjekje për të ndalur llumin dhe përbaltjen, përherë e më shumë në rritje, ka shumë. Përpjekje për ta bërë të zezën të bardhë ka shumë. Përpjekje për ta prezantuar çakallin luan ka shumë. Pengesa në rrugën e ndryshimit ka shumë. Mllefe historike ndaj Udhëzimit dhe Pastërtisë në këtë vend ka shumë. Zhytje në injorancë të orkestruar kolektive ka shumë. Diktaturë për të mbrojtur të keqen ka shumë. Fashizëm për të ndaluar rimëkëmbjen e vlerave ka shumë. Shumë ka, ka shumë..!

Por, ajo që kam dëshirë të ndaj sot me ju është një prag-limit i urtë në mendimin elitare të dijetarit dhe burrit të urtë të shekullit, Hoxhës tonë të madh, Shejkh Ahmed Keftaro, i cili thotë kështu: "Sa herë të shohësh një njeri që kundërshton Allahun e Madhëruar, dije se, dikush e ka ditur të vërtetën dhe ka neglizhuar të thërrasë drejt saj! Kur të shohësh një të shthurrur, kërkoji falje Allahut; ndoshta, gjynahu i tij është i lidhur me neglizhencën tënde!"

TATARISTANI OSE REPUBLIKA E TATARISTANIT

Tataristani, zyrtarisht Republika e Tataristanit, është një republikë e Federatës Ruse që gjendet në pjesën qendrore-lindore të Rusisë evropiane. Republika shtrihet në pellgun e mesëm të lumit Vollga, rreth bashkimit të lumenjve Vollga dhe Kama. Tataristani ka një sipërfaqe prej 67,847 km², dhe një popullsi prej 4,004,809 banorësh (2021). Republika kufizohet me rajonet e Kirov, Uljanovsk, Samara dhe Orenburg, si dhe me republikat Bashkortostan, Udmurtia, Mari El dhe Çuvashia.

Kazan është qyteti më i madh dhe kryeqyteti i vendit, dhe një qendër e rëndësishme kulturore në Rusi.

GJEOGRAFIA

Tataristani ndodhet në pjesën qendrore - lindore të Rrafshit të Evropës Lindore. Republika shtrihet rreth bashkimit të lumenjve Vollga dhe Kama (një degë e Vollgës), afërsisht 800 kilometra në lindje të Moskës, dhe në lindje shkon deri në malet Urale. Mbi 90% e territorit të vendit përfaqësohet nga ultësirat fushore, me disa zona malore në perëndim dhe juglindje, duke përfshirë zonat malore të Vollgës dhe të Bugulma-Belebey.

Vollga rrjedh në drejtimin veri-jug, përgjatë skajit perëndimor të republikës, ndërsa Kama, dega më e madhe e Vollgës, formon një bosht afërsisht lindje-perëndim përmes pjesës më të madhe të vendit. Lumenjtë Vjatka dhe Belaja janë degët kryesore të lumit Kama. Përgjithësisht relievi i vendit është një rrafsh i ulët, me disa shpate të buta, të valëzuara. Zona në perëndim të Vollgës ngrihet në 235 metra. Në lindje, toka vazhdon të ngrihet drejt maleve Urale.

Pjesa më e madhe e republikës shtrihet në zonën e stepave pyjore, me dhë të zezë (çernozem). Rreth një e gjashta e territorit të Tataristanit është e pyllëzuar. Lisi është specia mbizotëruese e pemëve, në 87% të sipërfaqes totale, e ndjekur nga plepi i egër, bliri, mështekna dhe pisha baltike. Përgjatë lumenjve ka livadhe të gjera lymore, megjithëse ato në Vollgë dhe në pjesën e poshtme të lumit Kama, janë zhdukur nën ujërat e rezervuarit të Nizhnekamsk-it dhe të rezervuarit të Samara-s, të cilët përmblytën më shumë se 2,850 km² tokë të republikës.

Në Tataristan ndodhen Rezervati Natyror Volga-Kama dhe Parku Kombëtar Nizhnaja-Kama.

KLIMA

Klima është kontinentale, me dimër të gjatë, të ashpër dhe verë të nxehtë. Temperaturat mesatare të Janarit janë rreth -11.9°C, kurse temperaturat mesatare të korrikut janë afërsisht 19.2°C. Reshjet vjetore shkojnë në rreth 420-510 mm, të cilat më shumë bien gjatë verës. Në dimër, që nuk bie shumë shi, trashësia e borës nuk i kalon 60 centimetra.



EKONOMIA

Megjithë sipërfaqen e tij të vogël, Tataristani zë një vend të rëndësishëm në ekonominë ruse si me industrinë ashtu edhe me bujqësinë, dhe konsiderohet si një nga rajonet më të zhvilluara ekonomikisht të Rusisë. Pasuria nëntokësore dhe sipërfaqësore e këtij vendi ndahet për investime përmes projekteve të Moskës, kështu që banorëve vendas i mbetet një pjesë shumë e vogël e prodhimit kombëtar bruto, në dispozicion.

Burimi kryesor natyror i republikës është nafta, por ka edhe gaz, përveç depozitave të pasura të bitumeve. Ekzistojnë gjithashtu mbi 100 depozita qymyri në qarqet Tatari jugor, Melekess dhe Tatari i veriut.

Ekonomia e republikës është kryesisht e orientuar drejt eksportit, dhe bazohet në prodhimin dhe rafinimin e naftës. Kompleksi i naftës, gazit dhe

kimikateve përfaqëson rreth 50% të vëllimit të përgjithshëm të prodhimit industrial dhe është më i rëndësishmi në drejtim të zhvillimit social dhe ekonomik, punësimit lokal dhe furnizimit të buxhetit të të gjitha niveleve.

Industri të tjera që kontribuojnë në potencialin industrial të republikës janë ndërmarrjet prodhuese të përfaqësuara nga ndërtimi i makinerive, prodhimi i pajisjeve, automjeteve dhe pajisjeve të transportit, produktet minerale jometalike, rrëshira dhe produktet plastike, pajisjet elektrike, pajisjet

elektronike dhe optike, përpunimi dhe prodhimi i drurit, industria e letrës, industria e produkteve të naftës, industria e lehtë dhe ushqimore.

Një pjesë e madhe e territorit të Tataristanit është e përshtatshme për bujqësi. Kulturat kryesore të kultivuara atje janë thekra, gruri, misri, liri, patatet dhe panxhari i sheqerit, gjithashtu edhe perimet e frutat. Blegtoaria, prodhimi i qumështit dhe i mishit, përbën gjithashtu një fushë të rëndësishme të aktivitetit ekonomik. Kompleksi bujqësor i republikës i plotëson pothuajse plotësisht nevojat e popullsisë.

Tataristani është një nga rajonet e avancuara të Rusisë në sektorët e IT-së dhe internetit.

GJUHA

Gjuha tatarë është gjuha kombëtare e Tataristanit. Ajo është një gjuhë e degës kipçak të familjes turke, e lidhur ngushtë

me kazakishten dhe bashkirishten, dhe pak më larg me turqishten, uzbekishten dhe uigurishten, dhe është gjuha e tretë më e folur në Federatën Ruse, me 3,26 milionë folës (regjistrimi rus 2021), pas rusishtes dhe anglishtes.

Gjuha tatarë dhe ajo ruse janë gjuhët zyrtare të Tataristanit, megjithëse në praktikë, gjuha tatarë është disi më e spostuar në administratë, arsim dhe media.

Përveç gjuhës tatarë dhe ruse, në Tataristan ka gjithashtu pakica që flasin gjuhët çuvash, udmurt, dhe gjuhë të tjera.

FEJA

Feja kryesore e Republikës së Tataristanit është Islami, i cili ndiqet nga 55% e popullsisë. Tatarët dhe Bashkirët janë ata që i përkasin tërësisht Islamit. Pastaj vjen krishterimi ortodoks, që ndiqet nga 40% e popullsisë, e përbërë nga rusët, çuvashët, marianët, udmurtët, mordovianët. 5% e popullsisë deklarohen si të pafe, ose të feve të tjera.

HISTORI

Shteti më i hershëm i njohur i organizuar brenda kufijve të Tataristanit ishte Bullgaria e Vollgës (rreth viteve 700–1238). Bullgarët e Vollgës kishin një shtet të avancuar tregtar me kontakte tregtare në të gjithë Euroazinë e brendshme, Lindjen e Mesme dhe Baltikun, i cili ruajti pavarësinë e tij pavarësisht presionit nga kombe të tilla si kazarët, Rusia e Kievit dhe Kuman-Kipçakët. Islami u prezantua në vend nga thirrësit muslimanë që erdhën nga Bagdadi, rreth kohës së udhëtimit të Ibn Fadlanit, në vitin 922.

Në fund të viteve 1230, Volga Bullgaria ra në duart e ushtrive të princit mongol Batu Khan. Banorët, një pjesë e madhe e tyre u vranë, dhe pjesa tjetër u përzien me Kipçakët e Hordhisë së Artë, dhe u bënë të njohur si "Tatarët e Vollgës". Në vitet 1430, rajoni u bë përsëri i pavarur, i njohur si Khanati i

KRYEQYTETI, KAZAN



KRYEQYTETI, KAZAN



XHAMIA KUL SHARIF, KAZAN

Kazanit, me kryeqytet Kazanin, 170 km nga kryeqyteti i dikurshëm i bullgarëve, lart Vollgës.

Në vitin 1550, Khanati i Kazanit u sulmua nga trupat e Carit, Ivanit të tmerrshëm, dhe në vitin 1552 Kazani u mor prej tij. Një numër i madh i tatarëve u konvertuan me forcë në krishterim dhe u rusifikuan kulturalisht, dhe në Kazan u ndërtuan katedralet. Nga viti 1593, të gjitha xhamitë në zonë u shkatërruan. Qeveria ruse e ndaloi ndërtimin e xhamive, ndalim ky që u hoq vetëm në shekullin e 18-të, nga Katerina e Madhe. Në vitet 1766-1770, nën kujdesin e Katerinës, u rindërtua xhamia e parë.

Gjatë Luftës Civile të viteve 1918-1920, nacionalistët tatarë u përpoqën të krijonin një republikë të pavarur (Shteti Idel-Ural / Idel është emri i Vollgës në gjuhën tatarë), së bashku me Bashkirët fqinjë. Fillimisht, i mbështetur nga bolshevikët, shteti ekzistoi deri në mars të vitit 1918, kur anëtarët e rangut të lartë të parlamentit të tij u arrestuan nga bolshevikët, përpara shpalljes zyrtare të kushtetutës së tij. Sovjetikët krijuan më vonë, më 27 maj të vitit 1920, Republikën Socialiste Sovjetike Autonome Tatarë. Kufijtë e kësaj republike nuk e përfshinin

shumicën e tatarëve të Vollgës. Në vitet 1921-1922, në Republikën Socialiste Sovjetike Autonome Tatarë ndodhi një zi buke, si rezultat i politikave të komunizmit. Vdekjet nga uria në mesin e popullsisë ishin katastrofike, pasi gjysma e tatarëve të Vollgës, brenda Bashkimit Sovjetik, vdiqën.

Duke filluar nga vitet 1960, në Tataristan u hapën shkolla ku rusishtja mësohej si gjuhë e dytë zyrtare, si nevojë për t'u integruar në shoqërinë e gjerë sovjetike, dhe deri në vitet 1980, vetëm në pak shkolla mësohej ende në gjuhën tatarë.

Më 30 gusht të vitit 1990, Tataristani shpalli sovranitetin e tij, me Deklaratën mbi Sovranitetin Shtetëror të Republikës Sovjetike Socialiste Tatarë. Në vitin 1992 Tataristani mbajti një referendum mbi kushtetutën e re, i promovuar nga presidenti i Tataristanit, Shajmijev, dhe i mbikëqyrur nga stafi i Komisionit të Helsinkit. Rreth 62% e atyre që morën pjesë në votim, votuan në favor të kushtetutës, dhe tatarët etnikë e mbështetën atë shumë më tepër se rusët. Në kushtetutën e re, Tataristani përkufizohet si shtet sovran. Megjithatë, referendumi dhe kushtetuta u shpallën jokushtetuese nga gjykata kushtetuese ruse. Nenet 1 dhe 3 të kushtetutës, të prezantuara në vitin 2002, e përcaktojnë Tataristanin si 'pjesë të Federatës Ruse', duke e hequr termin "sovranitet".

Më 15 Shkurt të vitit 1994, ishte nënshkruar një marrëveshje mes Federatës Ruse dhe Republikës së Tataristanit, për të përcaktuar kompetencat në fushën e marrëdhënieve ekonomike dhe të marrëdhënieve me jashtë. Marrëveshja për ndarjen e pushtetit u rinovua më 11 korrik të vitit

2007, megjithatë, pjesa më e madhe e pushtetit të deleguar në Tataristan u reduktua.

Më 20 Dhjetor të vitit 2008, në përgjigje të njohjes së Abkhazisë dhe Osetisë së Jugut nga ana e Rusisë, kuvendi i organizatës së Popullit Tatar të Krimesë, e shpalli Tataristanin të pavarur dhe kërkoi njohjen nga Kombet e Bashkuara. Megjithatë, kjo deklarata u injorua si nga Kombet e Bashkuara ashtu edhe nga qeveria ruse. Më 24 korrik të vitit 2017, marrëveshja e autonomisë, e nënshkruar në vitin 1994 midis Moskës dhe Kazanit, skadoi, duke e bërë Tataristanin republikën e fundit të Rusisë që e humbi statusin e saj të veçantë si autonome.

SI ERDHI ISLAMI NË TATARSTAN

Viti 922 - është viti në të cilin delegacioni i Ibn Fadlanit shkeli në tokat e Bullgarisë së Vollgës. Në këtë kohë, Khan El-Mush ishte mbreti dhe sundimtari i shtetit, nënshtetasit e të cilit më pas pranuan Islamin si fenë e vetme për vete dhe për vendin e tyre. Që nga ajo datë, një faqe e re do të fillonte në historinë e rajonit të Vollgës, dhe të përhapjes së besimit Islam atje.

Dita e 21 majit të vitit 922, u regjistrua përgjithmonë në historinë jo vetëm të popullit tatar, por edhe të gjithë rajonit të Vollgës, duke u bërë pikënisja për përhapjen e Islamit në vendet fqinje dhe integrimin e tij përgjithmonë me kulturën e popujve vendas, dhe duke u bërë pjesë përbërëse e pandashme e saj.

Misioni humanitar i Ibn Fadlanit luajti një rol vendimtar në përhapjen e Islamit në rajonin e Vollgës.

Ahmed ibn El-Abas ibn Fadlan, ishte një eksplorator dhe thirrës musliman arab. Ai i vizitoi brigjet e lumit Vollga në vitin 921-922, dhe i la shënimet dhe përshtypjet e tij në librin e tij të famshëm “Risalet Ibn Fadlan - Mesazhi i Ibn Fadlanit”, rreth këtij udhëtimi të tij të ri dhe interesant. Ai ishte një shkrimtar i madh, nën patronazhin e komandantit ushtarak Muhammed ibn Sulejman, i cili më parë kishte marshuar me ushtrinë e tij drejt tokave të Egjiptit (në vitet 904-905), me urdhër të kalifit abasid që e kishte selinë në Bagdad.

Në vitin e largët 921, me udhëzimet e kalifit abasid El-Muktedir Bil-lah, një delegacion fetar dhe politik u nis nga Bagdadi (i cili me të drejtë konsiderohej kryeqyteti i botës) për në Azinë Qendrore, me një mision informues-edukativ. Ky delegacion, i cili e përcaktoi mirë rrugën që do të ndiqte përmes bullgarëve të

Vollgës, përbëhej nga figura të ndryshme të shquara në fushën e jurisprudencës islame, politikës dhe historisë, me në krye Ahmed bin Fadlan, i cili konsiderohej si udhëtar i parë eksplorator arab në Rusi. Ky udhëtim përfaqëson një hap të madh në forcimin e lidhjeve fetare, kulturore dhe historike midis dy popujve, atij arab dhe atij tatar, në të ardhmen.

Misioni zyrtarisht drejtohej nga njeriu i zgjedhur i kalifit, Sausen Er-Rasi, por Ibn Fadlan ishte ai që u urdhërua të bëhej sekretari i delegacionit, dhe kjo i jep kuptim statusit të tij të lartë dhe prestigjit të tij. Sekretari ishte përgjegjës për të gjitha detyrat e rëndësishme dhe për mbarrëvajtjen e të gjitha punëve të delegacionit.

Kur karvanit të delegacionit i kishte mbetur vetëm një ditë rrugë për të mbërritur në Bullgarinë e Vollgës, katër princa të mbretit dhe sundimtarit El-Mush, përveç vëllezërve dhe djemve të tij, dolën për ta pritur ekspeditën. Ibn Fadlan shkruan: “Ata na pritën duke mbajtur bukë dhe mish në duar, dhe na shoqëruan derisa vetë mbreti na priti në një distancë prej 12 kilometrash nga pallati i tij. Kur mbreti na pa, zbriti nga kali dhe ra me fytyrën në sexhde duke falënderuar Zotin, Më të Lartin, Madhështorin.”

Pasi delegacioni mbërritën në Bullgarinë e Vollgës dhe pasi ndenjtën dhe biseduan me mbretin, Ibn Fadlan i lexoi mbretit mesazhin e Kalifit për të, i dha dhurata atij dhe të afërmeve të tij, dhe i foli për thelbin e Islamit, madhësinë dhe thjeshtësinë e tij.

Ibn Fadlan tregon se, kur ai e nxori letrën e kalifit dhe filloi ta lexonte, “Përkthyesi e përktheu letrën shkronjë për shkronjë. Kur përkthyesi mbaroi, ne njëzëri bërtitëm: “Allahu Ekber!”, me një zë nga i cili u drodh toka.”... Kështu e përshkroi Ibn Fadlan atë moment.

Që nga ajo ditë, bullgarët e Vollgës dhe e gjithë popullsia e atij vendi u konvertuan në Islam, dhe Islami u bë feja zyrtare e shtetit, duke u bërë kështu një pjesë e pandashme e botës islame. Prej këtu, nga kjo tokë, besimi islam filloi të përhapej në të gjithë rajonin e Vollgës, dhe u integrua plotësisht me kulturën dhe traditat e shumë popujve vendas.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

<https://russia-islworld.ru/kultura>
<https://islamansiklopedisi.org.tr>
<http://council.gov.ru/en>
<https://en.wikipedia.org>
<https://www.britannica.com>
<https://www.nationalia.info>



Rexhep Tajip Erdogan
President i Turkije-s

“**T**ashmë hilet e atyre që kapen pas pretekstit të ISIS-it, sa herë që përballen me ndonjë problem, janë zbuluar jemi të lodhur nga hipokrizia e atyre që përdorin ISIS-in dhe organizata të ngjashme, si front për interesat e tyre politike dhe ekonomike!



“MË E KEQE SE VETË VDEKJA” - ZËRA NGA LIBIA

Kryebashkiaku i Dernas ka paralajmëruar se 20 mijë njerëz mund të kenë humbur jetën në përmblytjet katastrofike që kanë goditur Libinë pas stuhisë Daniel.

Dëmi i vetë Dernës si qytet është katastrofik. Lagje të tëra janë bërë rrafsh me tokë. Shumë të mbijetuar janë duke pritur me dëshpërim lajmet për më të dashurit e tyre. Të tjerët janë në zi, për të vdekurit dhe për qytetin e tyre. “Nuk do të jetë më kurrë njëjtë”, ka thënë Amna. “Ato rrugë ishin gjithë jeta ime. E njihnim çdo cep të qytetit. Tani është zhdukur”.

Shenja e parë që diçka nuk shkonte ishte lehja e qenve. Ishte ora 2:30 e mëngjesit dhe jashtë ishte terr. Husam Abdelgawi, kontabilisti 31-vjeçar në qytetin libian Derna, u zgjua dhe zbriti i përgjumur poshtë për t’i kontrolluar qentë dhe ndjeu ujin në shputat e këmbëve.

Kur Husami hapi derën e përparme të shtëpisë që e ndante me vëllain e tij më të vogël Ibrahimin, uji vërshoi, duke e hequr derën nga vendi, ka treguar ai.

Vëllezërit vrapuan te dera e pasme, ku u përballën me skenën e kobshme, e paimagjinueshme, më e keqe se vetë vdekja për të dëshmuar.

“Trupat e grave dhe fëmijëve po kalonin pranë nesh”, ka rrëfyer Husam, në një intervistë telefonike nga qyteti i Al-Qubbahut. “Makinat dhe shtëpitë e tëra u kapën nga rryma. Disa prej trupave u futën nga uji në shtëpinë tonë”.

Uji i përfshiu edhe Husamin dhe Ibrahimin, duke i çuar më larg dhe më shpejt nga sa e imagjinonin. Brenda pak sekondave, ata ishin 150 metra larg njërit-tjetrit.

Ibrahimi, 28 vjeç, arriti të kapte kabllot lundruese të rrymës ende të lidhura në shtyllat e tyre dhe të kapej përsëri drejt vendit ku Husam ishte ngecur.

Vëllezërit i përdorën kabllot si litarë për t’u tërhequr drejt ndërtesës aty pranë dhe dolën përmes një dritareje të katit të tretë. Nga atje, ata kaluan në një ndërtesë tjetër dhe ngjitën një sërë shkallësh në një çati të katit të pestë, ku pritën përmblytjen.

“Zona ku ishim ishte një pjesë më e lartë e qytetit”, ka theksuar Husam. “Në pjesët e poshtme nuk besoj se ka shpëtuar njeri në katin e pestë apo të gjashtë. Mendoj se janë të gjithë të vdekur. Zoti i mëshiroftë shpirttrat e tyre”.

SHUMË TË VDEKUR

Më shumë se 5 mijë njerëz tashmë dihet se kanë vdekur në përmblytjet katastrofike që kanë goditur Libinë pas stuhisë Daniel. Kryebashkiaku i Dernas ka paralajmëruar se 20 mijë njerëz mund të kenë humbur jetën. Përmblytja u shkaktua nga thyerja e dy digave të ujit, duke bërë që uji të arrijë me vrull deri në qendër të qytetit.

“Derna u nda në dy gjysma nga uji dhe gjithçka në mes është zhdukur”, ka theksuar Rahma Ben Khayal, studente 18-vjeçare që arriti e sigurt në një çati në qytet.

“Njerëzit në mes janë të gjithë të vdekur”, ka treguar ajo.

Uji që përfshiu shumë rrugë kishte nisur si shi i dobët një ditë më parë.

Nuk ishte e frikshme në fillim, ka thënë Amna Al Ameen Absais, studente mjekësie 23-vjeçare e lindur dhe e rritur në Derna, e cila tani është kujdestare e tre vëllezërve e motrave të saj më të vegjël pas vdekjes së të dy prindërve nga sëmundja.

Teksa shiu pikonte jashtë, katër vëllezërit e motrat u ulën në apartamentin e tyre të katit të parë në Beach Towers, ndërtesë shtatëkatëshe, duke luajtur lojëra dhe duke përdorur telefonat e tyre. Ata e veshën vëllain e saj të vogël me jelek shpëtimi dhe qeshën. Por me kalimin e natës të së dielës, shiu u bë më i dendur. U dëgjuan sirenat. Ata nuk mund të flinin.

“Në të vërtetë, gjithçka nisi rreth orës 2:30 të mëngjesit”, ka thënë Amna, gjatë një interviste telefonike nga qyteti i afërt i Tobrukut. “Pikat e shiut po bëheshin më të shpeshta e më të rrëmbyeshme. Vëllai më tha se po e shihte rrugën tek sa po e merrte uji”.

Teksa niveli i ujit filloi të ngrihej, fqinjët filluan të migronin lart. Amna mori macen dhe katër pasaporta dhe ata u ngjitën nga apartamenti i tyre i katit të parë në një apartament në katin e tretë.

“Njerëzit po shikonin jashtë në terr, duke u lutur”, ka treguar Amna. Më pas uji arriti në katin e tretë.

“Të gjithë filluan të bërtisnin. Ne u ngjitëm përsëri, në katin e pestë dhe në fund u ngjitëm në katin e shtatë”.

Paniku kishte filluar. “E humba macen”, tregon Amna. “Kam humbur edhe vëllain tim të vogël për një minutë, por më pas e gjeta. Kuptova se nuk mund të

qëndronim as në katin e shtatë, duhej të shkonim në çati.

Prej aty, mund të shihnin fqinjët në çatinë e një ndërtese trekatëshe përballë, duke përfshirë nga uji një familje me të cilën ishin miq.

KONTAKTET E FUNDIT

Fqinjët tundnin telefonat në terr për të dhënë shenjë me dritë. Pak çaste më vonë, ndërtesa e tyre u shemb nga uji”.

“Dukej si tërmet”, ka theksuar Amna. “Ajo familje ende nuk është gjetur. Djali i tyre po i kërkon. Ne i thamë se e pamë ndërtesën e tyre që u shemb para syve”.

Disa nga familja e Amnës janë të zhdukur gjithashtu. Xhaxhai i saj, grua ja e tij dhe tre djemtë e tyre jetonin në një ndërtesë aty pranë që u shemb.

“Telefonata jonë e fundit ishte rreth orës 21:00, ai po telefononte për t’u siguruar që ne ishim mirë”, ka treguar ajo. “Ne nuk kemi dëgjuar prej tij që atëherë”.

Përfundimisht, Amna ishte në gjendje të shpëtonte nga ndërtesa me të tre vëllezërit e motrat, pasi ujërat u qetësuan. Rruga e saj ishte zhdukur plotësisht.

“Dukej sikur ishte çarë toka”, ka rrëfyer ajo. “Ka mbetur vetëm një zgavër aty ku ishte rruga”.

Një fqinj që ajo e njihte rrëshqiti dhe u zhduk në ujë para syve të burrit dhe djalit të saj, ka thënë Amna. Ajo dëgjoji se shoqja e saj më e mirë, Aisha, nuk ia kishte dalë.

Katër vëllezërit e motrat ecën për orë të tëra në një tokë më të lartë, duke kaluar plot trupa gjatë rrugës. Numri i të vdekurve nga katastrofa duket se do të rritet ndjeshëm.

Husam Abdelgawi, llogaritari, ka treguar se kishte numëruar tashmë të paktën 30 miq midis të vdekurve dhe më shumë se 200 të njohur. “Është mrekulli që mbijetova”, ka thënë ai.

Dëmi i vetë Dernës si qytet është katastrofik. Lagje të tëra janë shkatërruar.

Shumë të mbijetuar janë duke pritur me dëshpërim për lajmet e njerëzve të dashur. Të tjerët janë në zi, për të vdekurit dhe për qytetin e tyre.

“Nuk do të jetë më kurrë njëjtë”, ka thënë Amna. “Ato rrugë ishin e gjithë jeta ime. E njihnim çdo cep të qytetit. Tani është zhdukur”.

(Përktheu: **Blerta Haxhiu**
 marrë nga: www.koha.net)

NDERSHMËRIA E HAFIZ SABRI KOÇIT

Një hajdut shkruan një letër për komandantin e burgut, ku i thotë se Hafiz Sabri Koçi, nuk ka nxënë mend dhe vazhdon të predikojë e të falet edhe këtu.

- Makina e la pasi nuk bëri apelin, ai mund të arratisë. Të ikte nga të mundej dhe sa më tutje. - I erdhi ndër mend Sokrati i lashtësisë. Edhe ai kishte refuzuar të ikte nga burgu edhe pse e kishin mbyllur atje kot dhe e kishin dënuar me vdekje.

- Pastaj do t'i bëj keq, shumë keq, atij oficerit që më harroi, mendoi - U paraqit te dera prej hekuri e lyer me bojë jeshile sa ushtari që rrinte atje me pushkë në dorë, ngriti duart i çuditur.

SHPEND TOPOLLAJ

Në daç, ta quaje burg e në daç ta quaje kamp, Spaçi për të dënuarit s'ishte tjetër veçse vete Ferri. Ta kërkoje me qiri, vend më të përshtatshëm për ta vuajtur deri në palcë ndëshkimin nga ai sistem, nuk kishte se ku të gjeje. Këtë, si për të kënaqur synimet e komunistëve, e kishte favorizuar edhe natyra, duke fshehur rezerva të mëdha minerali. Aty qenë rrasur e plasur si të burgosurit politikë, ashtu dhe ata ordinerët. Mes tyre, i dënuar me shumë vite burg, ishte dhe Hafiz Sabri Koçi nga Orenja e Librazhdit, por që kishte banuar së fundmi në Shkodër. Një klerik i ulët mysliman kishte qenë ai, por shumë i përkushtuar dhe i ndershmë, ndaj e kishin dënuar aq rëndë. Kishin frikë nga influenza e tij mes besimtarëve dhe as që donin t'ia dinin se ai do e shkonte jetën si mos më keq. Nga familja rrallë i vinin për njëmijenjë arsye, se dhe të varfër ishin, ndaj shokët e përkrahnin sa dhe si mundnin atë. Kishte mësuar këtu në Spaç zanatin e hidraulikut dhe "Sabri këtu, Sabri atje" e urdhëronte kush të mundej. Këta klerikët janë të çuditshëm; sido që ta kenë hallin dhe sado që të jenë në kushte të vështira, përsëri nuk heqin kollaj dorë nga ritet fetare. Kështu edhe Hafizi i rrëgjuar nga mundimi e të pangrënët.

SPIUNËT

Por ja që ka ca tipa akoma më të çuditshëm që edhe në burg, kërkojnë t'i bëjnë tjetrit gropën. Spiunojnë në komandë me shpresën se duke groposur dikë, do kenë besimin e komandës dhe do mund të fitojnë ndonjë favor a privilegj të vogël. I mbushet mendja një hajduti dhe shkruan një letër për komandantin e burgut, ku i thotë se Hafiz Sabri Koçi, nuk ka nxënë mend dhe vazhdon të predikojë e të falet edhe këtu. E merr letrën komandanti i ri i kampit të Spaçit, të cilit i dhimbsej disi hoxha - hidraulik që i kishte treguar një herë sesi e kishin

arrestuar dhe trajtuar atje në birucat e degës së Punëve të Brendshme, ku duke kaluar nëpër ato korridore të zymta, kishte parë diçka jeshile dhe nga uria e tmerrshme që ulur dhe e kishte marrë. Qe gëzuar që ajo kishte qenë një copë buke e mykur, e kishte fshirë shtresën e sipërme dhe e kishte ngrënë me shumë kënaqësi. Edhe këtu ai më shumë rrinte pa ngrënë, pasi mishin e derit nuk e fuste në gojë. Po aty vetëm derra rrisnin. Prandaj, komandanti i ri vendosi që të shkonte drejt në dhomën e edukimit, ku mblodhi këshillin e riedukimit i cili përbëhej nga të burgosur të shkolluar dhe me sjellje të mira. Ishte aty Ali Çeno, Halit Maçi etj. I dërgoi një ushtar edhe Hajdarit nga Shkodra, i cili nuk po kuptonte përse e kishin thirrur. I pranishëm ishte dhe vetë Hafizi.

- Hajdari i mori fjalën komandanti. T më ke dërguar një letër mua, por unë dhashë e mora dhe nuk e lexoja dot se nuk e kuptoja shkrimin. Ku drejtin e ke bërë filloren ti? Tani merre letrën dhe lexoje të shohim shqetësimet që ke. E humbi fillin Hajdari dhe u skuq në fytyrë.

- Fol! A e ke shkruar ti këtë letër?

Ashtu si nëpër dhëmbë Hajdari u përgjigj "Po", por nuk mori përsipër ta lexonte.

- Mirë - vazhdoi komandanti. - Do ta lexojë dikush nga ju.

Dhe ia zgjati një inxhinieri që ndodhej aty për agjitacion e propagandë, kurse në të vërtetë, ngaqë e kishte gruan të huaj. Ky pasi u kollit si për të rregulluar zërin dhe tha se "Nuk e paska dhe aq të keq shkrimin Hajdari", filloi ta lexonte atë letër që e rëndonte Hafizin. Të gjithë heshtën dhe shihnin se ç'qëndrim do mbante Hajdari, ndërkohë që pohuan të kundërtën për Hafizin, duke thënë se ai nuk bënte gjë, por shihte punën e tij. Hajdari nga ana e vet, s'u ndie fare. Vetëm kur e pyeti komandanti se "ç'ke për të thënë?" u përgjigj:

- Po u dërgova më informacione unë,

mos më thënin...

Por informacione nuk dërguan më as të tjerët. Ata që nuk rrinin pa bërë ndonjë spiunllëk të vogël. Se kishin frikë se mos lexoheshin para shokëve dhe nofka spiun aty ishte barrë e rëndë për ta mbajtur në kuriz.

HUMBJA

Ndodhte që për nevoja të punës, disa të burgosur të shoqëruar me masa të rrepta sigurie, dilnin nga rrethimi i burgut dhe punonin diku tjetër. Kur distanca që e largët, i hipnin në një kamion dhe nën vëzhgim të rreptë i çonin te vendi i caktuar dhe si mbaronin punë i kthenin përsëri. Një herë, me ata që punonin diku larg, ishte dhe Hafizi. Me të mbërritur atje, morën lopatat dhe filluan nga puna. Si kaluan disa orë dhe vajti koha e drekës, oficeri që i shoqëronte, urdhëroi të mblidheshin të burgosurit dhe të hipnin me gjithë vegla në kamion. I bindur se të gjithë qenë aty, ai i tha shoferit të nisë. Mirëpo kishte ndodhur ajo që s'pritej. Kishte mbetur atje Hafiz Sabri Koçi. Fillimisht, mungesën e tij askush nuk e vuri re. Ca të lodhur nga puna e ca të pamësuar me praninë e tij në punët që kryheshin jashtë telave, atë nuk e kuptuan as shokët e tij. Kur Hafizi vjen te vendi ku priste makina, habitet që nuk sheh askënd aty. S'po u zinte besë syve. Kujtoi një paragraf të Kur'anit dhe u bind akoma më shumë se Zoti nuk e kishte harruar.

Për t'u siguruar thirrë dikë nga shokët në emër, por përgjigje nuk mori. Si mbetej tjetër, veçse të besonte se ata e kishin harruar. Aty për aty, mendoi të merrte malet. Të ikte nga të mundej dhe sa më tutje. Derisa të kalonte kufirin se helbete kishte edhe shumë vite për të bërë. Nga erdhi ky fat, mendoi. Pa andej, pa këndej dhe syri veç rripa të thikta dhe të frikshme i zuri. Vetja iu duk fare i vogël për t'i kapuar. Po çfarë do mendonin për njeriun e perëndisë, atë që predikonte ligj e bindje. I erdhi

ndër mend Sokrati i lashtësisë. Edhe ai kishte refuzuar të ikte nga burgu edhe pse e kishin mbyllur atje kot dhe e kishin dënuar me vdekje. Dhe kështu ishte bërë i pavdekshëm dhe kujtohej si filozof edhe sot e kësaj dite. Pastaj do t'i bëj keq, shumë keq, atij oficerit që më harroi, mendoi. Vendin e tij në burg, do e zinte ai. Do e zinte për t'u thënë të tjerëve, se kështu do e pësojë kushdo që humbet vigjilencën. Por edhe shokët do kishin pasoja. Jo pse nuk i treguat oficerit dhe rojave, jo po me kë ishte lidhur Hafizi...

Por dhe masat shtrënguese ndaj tyre, do shtoheshin. Shkarazi erdhi ndër mend edhe komandanti i burgut që kish vepruar me aq takt me atë që dërgonte letra, gjë që nuk para ngjiste shpesh. Ndaj si e peshoi mirë situatën, vendosi të nisëj pa humbur kohë dhe të paraqitej në kamp-burgun e Spaçit, atje ku ai prej vitesh kishte "shtëpinë".

HABIA E USHTARIT

Eci dhe eci, sa djersët e mbytnë dhe fryma po i merrej. Edhe uria po e mundonte. Pas gjashtë orësh rrugë e pa rrugë, dhe i çjerrë për gazep nga ferrat e shumta. u duk zymtësia e atij vendi të llahtarshëm, që s'kishte rëndësi në e quaje kamp apo burg. Në fillim dalloj tymin e bardhë. Kështu ka qenë edhe tymi i krematorëve, tha me vete. Po zihet nëpër kazanë mishi i derit. Dhe i erdhi për të vjellë. Mos e kam gabim që shkoj me këmbët e mia te ata xhahilë? Jo, jo, Zoti do të ma dijë këtë që po bëj. Ata që urdhërojnë këto llahtarë do mallkohen prej tij.

U paraqit te dera prej hekuri e lyer me bojë jeshile dhe ushtari që rrinte atje me pushkë në dorë, i çuditur, i thirri me zë të lartë e të prerë, oficerit të rojës. Ky erdhi menjëherë dhe pyeti:

- Sibri, po ti këtu. Nga dole?

- Lëre, lëre, ç'më gjeti. - nisi haxha justifikimin që e kishte menduar me kohë.

- Më kishte zënë gjumi atje ku na shpunë për të punuar dhe e pësova; kam gjashtë orë që udhëtoj i vetëm, në vende të panjohura. Po shqyr... - desh të thotë: Allahut, por e mbajti gojën.

E futën brenda dhe ç'çuan te komandanti i kampit. Ky, pasi dëgjoi ato që i tha dhe kuptoi se ai nuk donte të ngatërronte njeri, e pa butë drejt e në sy, si për t'i dhënë të kuptonte se i ishte mirënjohës dhe ia kishte larë atë qëndrimin ndaj atij hajduti që shkruante letra.

(Marrë nga gazeta Telegraf e datës 14 shtator 2023)

DITËLINDJA E BEGATË E PROFETIT (A.S) FESTË ZYRTARE NË ARABINË SAUDITE



Mbretëria e Arabisë Saudite ka njoftuar, se dita e mërkurë, më 27 shtator 2023, që përkon me 12 Rabiul-Evvël 1445 Hixhri, do të jetë festë zyrtare me pagesë për punonjësit e sektorit qeveritar, për nder të përvjetorit të Ditëlindjes së Profetit (a.s).

Qeveria e Arabisë Saudite ka lëshuar një vendim, në të cilin sqaron

se orari zyrtar i punës do të rifillojë pas përfundimit të festës së Ditëlindjes së Profetit (a.s) dhe se kjo festë do të zbatohet edhe në sektorët e tjerë të punës në Mbretërinë e Bashkuar.

Vendet arabe dhe islame e konsiderojnë festë zyrtare Ditëlindjen e Profetit (a.s) dhe u japin pushim punëtorëve të sektorit publik dhe privatë çdo vit.

FUTBOLLISTI GJERMAN ROBERT BAUER KONVERTOHET NË ISLAM

Futbollisti gjerman Robert Bauer, lojtar i skuadrës Saudite Al-Tai, deklaroi konvertimin e tij në Islam përmes profilit të tij zyrtar në Instagram.



VEPRIMTARI ARGËTUESE NË KODRAT E TEPESE ME NXËNËSIT E MEJTEPIT TË XHAMISË URA E BUNËS

Ditën e shtunë, më 09 shtator 2023, në kodrat e Tepes, sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër zhvilloi aktivitetin “Mësojmë dhe argëtohem”, me pjesëmarrjen e rreth 20 nxënësve të mejtepit fetar të xhamisë Ura e Bunës, nën shoqërimin e mësuesit, Ridvan Luzaku.

Në këtë aktivitet ishte i pranishëm teologu Arben Halluni, drejtuesi i arsimit, i cili pasi i uroi mirëseardhjen nxënësve në këtë veprimtari arsimore-argëtuese të radhës, u mbajti një bisedë të shkurtër me vlera edukative dhe me këshilla mjaft të vlefshme për këtë brez të ri, i cili kërkon një vëmendje të vazhdueshme nga të gjithë.

Më pas, programi vijoi me zhvillimin e bisedave brenda grupeve, lojëra të ndryshme sportive, shëtitje në natyrë, etj.



MYFTIU: MEDRESEJA JONË, GJURMË E LASHTË E EDUKIMIT DHE DIJES

Ditën e hënë, më 11 shtator 2023 filloi viti i ri shkollor për të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar.

Në ceremoninë e organizuar me rastin kësaj dite, në Medresenë “Haxhi Sheh Shamia”, mbajti një fjalë përshëndetëse edhe myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.

Në fjalën e tij Myftiu falënderoi drejtuesit e Medresesë, stafin pedagogjik, prindërit dhe fëmijët për përkushtimin e tyre dhe theksoi se “Medreseja jonë është gjurmë e lashtë e edukimit dhe dijes, që nuk përkufizohet me një vit a një dekadë, as me një shekull jetë, por është vijimësi e rrugës së hapur nga Hazreti Muhammedi (a.s.), i cili u porositi nga Zoti i gjithësisë, që këtë thirrje të begatë islame dhe njerëzimin ta merrte për dore drejt pastërtisë dhe zhvillimit nëpërmjet rrugëve të dijes.”

Myftiu theksoi, se “fillimi i vitit të



ri shkollor është një sinjal i begatë për fëmijët tanë për të nisur një vit të ri, për t'u rritur përherë e më tepër në kërkimin e dijes, në përkushtimin e tyre ndaj Zotit,

ndaj jetës, për të hedhur hapa të sigurt drejt një të ardhme më të mirë për veten, për familjen, për kombën.”

IMAM DIDMAR FAJA, MIK I SHTRENJTË I MYFTINISË SHKODËR!

Ditën e xhuma, më 15 shtator 2023, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt Kryetarin e Këshillit të Imamëve të Arizonës, njëkohësisht Kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar të Arizonës, Imam Didmar Faja.

Bisedat vëllazërore, kujtimet dhe eksperiencat e ndërsjellëta, ishin pjesë e bashkëbisedimit vëllazëror.

Myftiu Sytari falënderoi të nderuarin Imam Didmar Faja për vizitën dhe përgjigjen e ftesës për të marrë pjesë në aktivitetet e Myftinisë Shkodër me rastin e Mevludit Sherifë, si dhe takimeve të ndryshme me imamët, besimtarët etj.

Pas vizitës në zyrën e Myftiut, Imam Didmar Faja, mbajti hytben e xhumasë në xhaminë e Parrucës, ku hodhi dritë



mbi disa prej shkaqeve që sjellin në konvertimin e amerikanëve në Islam.

Hytbeja e djalit besnik të Shkodrës

krijoi një impakt pozitiv tek besimtarët e shumtë, sidomos për argumentet dhe statistikën me vlerë.

“HZ. MUHAMMEDI (A.S), DRITË UDHËZIMI PËR GJITHËSINË!” AKTIVITET ME RASTIN E MEVLUDIT SHERIFË

Ditën e enjte, më 21 shtator 2023, me rastin e Mevludit Sherifë, Myftinia Shkodër organizoi në xhaminë e Medresesë tribunën me temë: “Hz. Muhammedi (a.s), dritë udhëzimi për gjithësinë!”, ku i ftuar special i këtij aktiviteti ishte Imam Didmar Faja, Imam i United Islamic Center of Arizona dhe kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar të Arizonës – ShBA.

Aktivitetin e hapi teologu Gëzim Dunga, nëndrejtor për lëndët fetare në Medrese.



Më pas përshëndeti, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili vuri theksin te rëndësia e të qenurit medresist dhe roli i tyre në shoqëri, duke u prezantuar si muslimanë të denjë, me moralin, urtësinë, dijen, pjekurinë dhe qëndrueshmërinë e tyre në rrugën e ndritur të besimit islam.

Fjalën kryesore e mbajti Imam Didmar Faja, i cili në ligjëratën e tij hodhi dritë mbi rëndësinë e pasimit të traditës së të Dërguarit të Allahut dhe se atë duhet ta përkujtojmë dhe ta ndjekim gjatë gjithë jetës sonë, megjithëse në

këtë muaj, duhet ta njohim më tepër Pejgamberin (a.s), veçanërisht përmes tribunave dhe aktiviteteve të ndryshme, që organizohen brenda muajit Rebiul-Evvel, muajit të Lindjes së Begatë të Hz. Muhammedit (a.s).

Imam Faja iu drejtua nxënësve të Medresesë edhe me një mesazh të rëndësishëm për ta, duke u kujtuar atyre se të jesh medresist është nder dhe se që nga hapja e kësaj shkolle dhe deri më sot, medresistët e Shkodrës kanë lënë gjurmë të mira kudo që kanë shkuar dhe janë ndër krenarë me lidhjen e tyre me Medresenë.

Përpara aktivitetit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dha një mesazh të rëndësishëm përpara mediave, me rastin e Ditës Botërore të Paqes.

PROGRAM FETARO-ARTISTIK PËR MBYLLJEN ME SUKSES TË MEJTEPIT VEROR NË GANJOLLË

Pasditën e së enjtes, më 21 shtator 2023, Myftinia Shkodër, përmes sektorit të arsimit zhvilloi një program fetaro-artistik për mbylljen e kursit/mejtepit veror në xhaminë e Ganjollës.

Krahas 36 nxënësve, merrnin pjesë drejtues të Myftinisë, imamë, prindër, besimtarë, të rinj të reja etj.

Aktiviteti filloi me lexim nga Kur'ani Famëlartë dhe më pas përfaqësuesi i Myftinisë, drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni mbajti një fjalë përshëndetëse, ku u përqendrua në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin si përçimin te brezi i ri të mësimeve të vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit Fuqplotë.

Programi vijoi më recitime, mesazhe, pjesë me vjersha, ilahi dhe prezantim të disa temave besimore dhe edukative, të prezantuar nga nxënësit e mejtepit



dhe të përgatitur nga imami i xhamisë së Ganjollës, Erion Hasmegaj.

Në fund, u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së 36 certifikatave dhe dhuratave për nxënësit e dy xhamive Ganjollë dhe Mjedë që marrën pjesë në kursin intensiv veror.

Ky aktivitet përkoi në prag të përkujtimit të Mevludit Sherif, Ditëlindjes së Begatë të Pejgamberit Muhammed (a.s), si dhe në kudër të 15 vjetorit të rinovimit dhe rikonstruksionit të xhamisë Ganjollë.



MYFTIU PRITI DREJTORIN E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NDËRKOMBËTAR PRANË "QATAR CHARITY"

Ditën e martë, më 26 shtator 2023, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, Drejtorin e Programeve të Zhvillimit Ndërkombëtar pranë "Qatar Charity" në Doha të Katarit, Abdulaziz Jassim Hejji.

Gjatë këtij takimi të përzemërt, Myftiu e njohu mikun e nderuar me historinë e aktivitetit islam në Shkodër, të shkuarën dhe të sotmen, projektet dhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit në kuadër të forcimit të vlerave islame dhe mesazheve të mesatarizmit që Myftinia Shkodër përpiqet të përhapë nëpërmjet aktivitetit të saj.

Nga ana e tij, z. Hejji, e falënderoi Myftiun e Shkodrës për mikpritjen dhe vullnetin e bashkëpunimit, sikurse garantoj se "Qatar Charity" punon për zhvillimin e projekteve të ndryshme, që i shërbejnë aktivitetit fetar islam në vende të ndryshme të botës.

Pjesë e bashkëbisedimit vëllazëror ishte edhe historia e trashëgimisë



islame, gjurmët e të shkuarve, punimet e hoxhallarëve të shkuar të Shkodrës, etj.

Në takim ishte i pranishëm edhe nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Tauland Bica, drejtori i "Qatar Charity" për Shqipërinë, Mahmud Shakir dhe miq të nderuar në shoqërinë e tyre.

U ZHVILLUA CEREMONIA SIMBOLIKE PËR XHAMINË E RE TË TOPHANËS



Ditën e martë, më 26 shtator 2023, që korrespondon me Ditën e madhe të përkujtimit të Lindjes së Begatë të Hz. Muhamedit (a.s), të Dërguarit mëshirë për gjithësinë, u zhvillua ceremonia simbolike e nisjes së punimeve për projektin e xhamisë së re të lagjes Tophanë.

I pranishëm ishte Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, Drejtori i Programeve të Zhvillimit Ndërkombëtar pranë "Qatar Charity" në Doha të Katarit, Abdulaziz Jassim Hejji, Nënkryetari i Bashkisë Shkodër, Onid Bejleri, Drejtori i "Qatar Charity" për Shqipërinë, Mahmud Shakir, imamë, miq e dashamirë të Myftinisë Shkodër.

Në fjalën e rastit, Myftiu falënderoi bashkëpunimin me "Qatar Charity" për realizimin e këtij projekti të shumëpritur për bashkësinë muslimane të Shkodrës, Bashkinë Shkodër për mirëkuptimin dhe lehtësimin e procedurave të lejeve përkatëse dhe komunitetin për nxitjen e vazhdueshme dhe dëshirën e madhe për xhaminë e re.

Me tekbiere, Myftiu i Shkodrës, miku i nderuar i ardhur nga Katar, nënkryetari i Bashkisë dhe drejtori i "Qatar Charity" për Shqipërinë, i dhanë fillim punimeve për realizimin e këtij projekti me vlerë për Myftininë Shkodër dhe krejt Shkodrën.



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

“

Shembulli

i shkëpisë

në të cilën i bëhet

dhikër All-llahut

dhe shkëpisë

në të cilën nuk i bëhet

dhikër All-llahut,

është si shembulli

i të gjallit

me të vdekurin!

(Transmetuar nga Buhariu)





H. Muhamed Bektashi
(1883-1958)



“Nuk do të jepet gjë më e shtrenjtë
se sa KOHA
nëpërmjet së cilës
mund të arrish çdo krenari e nder!

Prandaj, **mos e humb këtë KOHË**
të shtrenjtë duke e shpenzuar
për pasionet e shthurura..!”

www.myftinia-shkoder.org

  [myftiniashkoder1990](https://www.youtube.com/myftiniashkoder1990)

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org